

**NGRITJA E DUARVE
(PARA DHE PAS RUKUSË)
NË NAMAZ**

Imam Buhariu

Parathënia nga hoxhë Bajram Karabeg

2023 / 1444 *h*

Titulli:
Ngritja e duarve (para dhe pas rukusë) në namaz

Titulli në arabisht:
رفع اليدين في الصلاة
(*Raf'ul-jedejni fis-salah*)

Autor:
Imam Buhariu

Përktheu nga gjuha arabe:
Adnan Nikezi

Redaktor gjuhësor:
Jeton Koqinaj

Ballina:
Fatlum Zeka

Botim privat:
© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara - Adnan Nikezi

2023 / 1444 h

IMAM BUHARIU

NGRITJA E DUARVE (PARA DHE PAS RUKUSË) NË NAMAZ

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

*Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!*

Parathénie

Parathënie

Me emrin e Allahut, Mëshirëplotit, Mëshiruesit!

Allahun e Madhërishëm e lavdërojmë dhe e falënderojmë e vetëm prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. Dëshmojmë se përveç Allahut askush nuk meriton të adhurohet, si dhe dëshmojmë se Muhamedi ﷺ është rob dhe i Dërguari i Tij.

Allahu Dijeplotë i shpalli Muhamedit ﷺ argumente të qarta për t'ua mësuar njerëzve rrugën e drejtë, e cila i shpie ata drejt kënaqësisë së Allahut të Lartësuar, prandaj paqja dhe bekimet e Allahut Bujar qofshin mbi Muhamedin ﷺ, mbi familjen e mbi shokët e tij dhe mbi të gjithë ata që do ta ndjekin udhëzimin dhe Sunetin e tij deri në Ditën e Fundit.

Lexues i nderuar, autori i librit që mbani në duar, përkatësisht dijetari Muhamed ibn Ismaili, ndryshe i njohur si imam Buhariu (Allahu e mëshiroftë!) është ndër dijetarët më të shquar të historisë islame dhe autori i librit më të saktë, pas Librit të Allahut Dijeplotë, përkatësisht librit të shquar e të njohur me titull “Sahihu i Buhariut”, për të cilin të gjithë dijetarët, nga koha e tij e deri më sot pohojnë unanimitisht se çdo transmetim që ndodhet brenda tij tregon fjalë ose vepër autentike të të Dërguarit të Allahut ﷺ.

Kurani famëlartë i kushton rëndësi të veçantë Sunetit të Pejgamberit ﷺ dhe, rrjedhimisht, Allahu Urtiplotë, në më shumë se shtatëdhjetë ajete, nxit ndjekjen e jetësimin e udhëzimeve dhe mësimave të profetit Muhamed ﷺ.

Allahu Dijeplotë në Librin e Tij thotë:

“... E, nëse i bindeni atij, do të jeni në rrugën e drejtë...” (Nur, 54)

“Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit, për të shpresuar mëshirën e Allahut.” (Ali Imran, 132)

“Çfarëdo që t’ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t’ju ndalojë, hiqni dorë prej saj.” (Hashr, 7)

“Le të ruhen ata që kundërshtojnë urdhrin e tij, që të mos i arrijë ndonjë provë ose që të mos i godasë një dënim i dhembshëm.” (Nur, 63)

Madje, për të vënë në pah rëndësinë jetike të pasimit të Pejgamberit ﷺ, Allahu Urtiplotë e ka ndërlidhur dashurinë e Tij me pasimin e Sunetit të Pejgamberit fisnik ﷺ. Ai thotë:

“Thuaju (o Muhamed): “Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë dhe t’jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë.” (Ali Imran, 31)

“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut. Sa për ata që kthejnë kokën mënjanë, Ne nuk të kemi dërguar që të jesh rojtar i tyre.” (Nisa, 80)

Nisur nga ky parim, dijetarët e hershëm dhe të tjerët që kanë ecur gjurmëve të tyre i kushtonin rëndësi të veçantë pasimit të Sunetit të Pejgamberit ﷺ dhe ruheshin të mos binin në kundërshtim me të. Kur dijetarët e ehlu sunetit panë se nëpër disa provinca të caktuara njerëzit filluan të braktisin një nga sunetet e formës së namazit, siç ndodhi në provincën e Kufes, përkatësisht filluan të braktisin ngritjen e duarve gjatë tekbitit para rukusë dhe pas ngritjes prej saj, morën të shkruanin libra që shpjegojnë dhe sjellin në dritë vërtetësinë e kësaj çështjeje.

Këtu do të përmend disa nga thëniet e dijetarëve dhe librat që janë shkruar rreth rëndësisë së pasimit të këtij suneti të Pejgamberit ﷺ në formën e faljes së namazit, të cilat, në të njëjtën kohë, aludojnë në rëndësinë e kësaj praktike. Madje, vetë imam Buhariu, autori i këtij libri (Allahu e mëshiroftë!) e ka sjellë në dritë këtë libër vetëm për t'ua bërë me dije muslimanëve rëndësinë e madhe të kësaj praktike të Pejgamberit ﷺ, për të cilën disa dijetarë thonë se është sikurse konsensus i dijetarëve të të gjithë brezave dhe të të gjitha vendeve, përveç Kufes.

Abdullah ibn Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: “Shpresoje që për çdo gisht dhe çdo një të gishtërinjve do të shpërblehem me nga dhjetë sevape.”¹ Po ashtu, transmetohet se, kur Abdullah Ibn Omeri shihte në xhami ndokënd që nuk i

¹ *Ref'ul jedejni fis-salat*, Ibn Kajim el Xheuziu, f. 135.

ngrinte duart (para dhe pas rukusë), e gjuante me guralecë për t'ia tërhequr vërejtjen dhe i thoshte: “O filan, ngriji duart!”¹

Dijetari i mirëfilltë, Ibn Rexheb Hanbeliu (v. 795 h.), thotë: “Shkakun pse dijetarët i kanë kushtuar rëndësi të veçantë kësaj është fakti se të gjitha trevat muslimane, duke filluar nga Hixhazi (ku përfshihen Meka, Medina dhe Xhideja), Jemeni, Egjipti dhe Iraku e kishin ngritjen e duarve gjatë rënies dhe ngritjes nga rukuja pjesë të pandashme të namazit, me përjashtim të banorëve të Kufes, të cilët i nginin duart vetëm në tekbirin fillestar.”²

Imam Evzaiu (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: “Të gjithë dijetarët e Hixhazit, të Shamit dhe të Basrës pohonin se Pejgamberi ﷺ i ngrinte duart paralel me supet e tij në tekbirin fillestar, kur binte në ruku dhe kur ngrihej nga rukuja, me përjashtim të banorëve të Kufes, të cilët, në këtë rast, binin ndesh me brezat e mëhershëm të dijetarëve të tyre.”³

Muhamed ibn Nasr Merveziu thotë: “Nuk dimë që ndonjë vendbanim i muslimanëve e ka braktisur ngritjen e duarve gjatë rënies dhe gjatë ngritjes nga rukuja, përveç banorëve të Kufes.”⁴

Dijetarët tregojnë se hadithet që përmendin ngritjen e duarve para rënies dhe gjatë ngritjes nga rukuja janë të shënuara në të gjithë librat burimorë të literaturës islame, si: në Sahihun e

¹ *Et-Temhid*, Ibn Abdulberri, 9/224.

² *Fet'hul Bari*, Ibn Rexheb Hanbeliu, 4/204.

³ *Fet'hul Bari*, Ibn Rexheb Hanbeliu, 4/204.

⁴ *Fet'hul Bari*, Ibn Rexheb Hanbeliu, 4/204.

Buhariut, Sahihun e Muslimit, Sunenin e Ebu Davudit, Sunenin e Tirmidhiut, Sunenin e Ibn Maxhes, Sunenin e Nesaiut, Muvatanë e imam Malikut, Musnedin e imam Ahmedit, Musnedin e imam Darimiut etj. Pra, është nga sunetet e rralla që ndodhet në gjashtë koleksionet e hadithit. Edhe dijetari Bedrudin el Ajni, nga brezat e mëvonshëm, nga radhët e medhhebit hanefi, në librin e tij “Umdetul Kari” thotë se ngritjen e duarve gjatë rënies dhe ngritjes nga rukuja e transmetojnë përafërsisht njëzet e pesë sahabë të Pejgamberit ﷺ.

Dijetari i mirënjohur Ibn Kajim el Xheuziu përmend se dhjetë të përgëzuarit me Xhenet i ngrinin duart kur binin dhe ngriheshin nga rukuja.¹

Tërë kjo na bën të kuptojmë se dijetarët e këtij umeti, të cilët e shënuan dhe e përcollën Sunetin e Pejgamberit ﷺ, si: imam Maliku, imam Ahmedi, imam Buhariu, imam Muslimi, Ebu Davudi, Tirmidhiu, Ibn Maxhe, Nesaiu, si dhe dijetarë të tjerë nga radhët e fukahave të dijetarëve të hadithit, si: imam Shafiu, Muzeniu, Muhamed ibn Nasr Merveziu, Is’hak ibn Rahuje etj., që të gjithë pohonin se ngritja e duarve para rënies në ruku dhe gjatë ngritjes hyn në radhën e suneteve të forta të trashëguara brez pas brezi nga gjenerata e artë e muslimanëve dhe ishte e pranishme në të gjitha viset muslimane përveç Kufes.

¹ *Ref’ul jedejni fis-salat*, Ibn Kajim el Xheuziu.

NGRITJA E DUARVE (PARA DHE PAS RUKUSË) NË NAMAZ

Ndër autorët që kanë shkruar në këtë tematikë mund të përmendim:

1. Muhamed ibn Abdullah ibn Ismail Buhariu (Allahu e mëshiroftë, v. 256 h.) i cili, në librin e tij të titulluar *“Xhuz’ reful jedejni fis-salah”* (*Libërthi për ngritjen e duarve gjatë namazit*) ka përmendur 196 hadithe dhe tekste nga brezat e parë besnikë lidhur me tematikën e ngritjes së duarve në namaz. Ky libër, në të njëjtën kohë, është libri i parë i shkruar në këtë tematikë që na ka arritur neve;

2. Ahmed ibn Amër el Bezari (Allahu e mëshiroftë, v. 292 h.);

3. Muhamed ibn Nasër Merveziu (Allahu e mëshiroftë, v. 294 h.), nga libri i të cilit kanë cituar një mori dijetarësh, ndër ta edhe dijetari i njohur Ibn Abdulberri në librin e tij *“Et-Temhid”* dhe në librin tjetër *“Istidhkar”*;

4. Ahmed ibn Shuajb Nesaiu (Allahu e mëshiroftë, v. 303 h.), librin e të cilit Ibn Rexhebi e përmend në *“Fet’hul Bari”*;

5. Ebu Nuajm Ahmed ibn Abdullah Asbahani (v. 430);

6. Hakim ibn Abdullah Nejsaburi (v. 405 h.);

7. Ahmed ibn Husejn Bejhekiu (v. 458 h.);

8. Ebu Zekerija Muhjidin Neveviu (v. 676 h.), i cili, në librin *“El-Mexhmu”* i ka përmbledhur argumentet për ngritjen e duarve gjatë namazit;

9. Tekijudin Subki;

10. Ibn Kajim el Xheuziu, i cili, në librin e tij voluminoz dhe përmbledhës, ka tubuar argumentet e të gjithë dijetarëve që kanë ndjekur rrugën e jetësimit të këtij suneti, si dhe argumentet e palës që nuk përkrahin ngritjen e duarve para dhe pas rukusë, duke vënë në pah argumentimin e tyre të dobët në këtë tematikë.

Ndër gjërat që tërheqin vëmendjen është edhe libri i autorit Muhamed ibn Ismail Abdulganij Velijullah Dehleviu (v. 1246 h.) me titull “Tenvirul-ajnejn fi ref’il-jedejn” (Ndritja e syve rreth ngritjes së duarve), i cili, edhe pse ka jetuar në një ambient ku nuk është jetësuar kjo praktikë, për shkak të përhapjes së medhhebit hanefi në ato anë, megjithatë ka vendosur t’ia kushtojë kësaj tematike një libër të tërë për shkak të argumenteve të fuqishme e të pakontestueshme që mbështesin këtë praktikë profetike.

Brezat e parë na kanë mësuar se namazi i personit është tregues për veprat e tij në përgjithësi. Nëse muslimani është i kujdesshëm ndaj namazit të vet dhe e kryen atë me përkushtim e përsosuri, e dimë se edhe veprat e tjera i ka të tilla, si dhe anasjelltas, nëse ka ngecje e mospërfillje ndaj namazit të tij, të gjitha veprat e tjera do t’i ketë të tilla. Muhamed ibn Munkediri (Allahu e mëshiroftë!), dijetar nga brezi i tabiinëve, ka thënë: “Jam përpjekur të jem i përkushtuar gjatë namazit (ta përsos atë) për njëzet vjet me radhë, e pastaj gjatë njëzet vjetëve të tjerë jam kënaqur në namazin tim.”¹ Po ashtu, Hasan el Basriu (Allahu e mëshiroftë!) thoshte: “Njeriu i

¹ *Sjër a’lam en-nubela*, Dhehebiu, 5/224.

NGRITJA E DUARVE (PARA DHE PAS RUKUSË) NË NAMAZ

udhëzuar matet me përsosjen dhe përkushtimin e tij ndaj namazit. Nëse shihnim ndokënd se është i kujdesshëm ndaj namazit të tij: në tekbinin fillestar, në ruku, në sexhde ose në cilëndo pjesë të namazit, kishim shpresa se është i mirë, e, nëse shihnim lëshime në këto gjëra, i fshinim duart nga ai.”

Sa i përket formës së namazit, nuk ka asnjë hadith që rrëfen se i Dërguari ﷺ ua kishte mësuar sahabëve namazin duke ua përshkruar me fjalë, por shumicës së sahabëve ua kishte dëftuar në praktikë duke u falur para tyre, siç transmetohet se njëherë kishte hipur në minberin e xhamisë dhe ishte falur për t'u treguar praktikisht se si falet namazi. Ai ﷺ vetë thoshte: “Faluni siç më keni parë mua duke u falur.”¹

Nga këto fakte që u përmendën na bëhet e qartë se njerëzit më kompetentë për të na treguar se si falet namazi janë shokët e Pejgamberit ﷺ, pasi që ata vetë e panë të Dërguarin e Allahut ﷺ me sytë e ballit e si falej. Bedrudin el Ajni transmeton se mbi njëzet e pesë shokë të Pejgamberit ﷺ kanë rrëfyer ngritjen e duarve para rënies dhe gjatë ngritjes nga rukuja, gjë e cila dëshmon se një veprim i tillë ka qenë i shquar dhe i njohur në mesin e tyre. Prandaj, ai që ia ka mësyre ndjekjes dhe jetësimit të praktikës së Profetit të mëshirës ﷺ nuk ka se si t'i ikë përngjasimi me të në veprën që llogaritet thelbi i imanit, respektivisht në formën e faljes së namazit.

¹ *Sahih Buhariu*, 631.

Me këtë libër imam Buhariu, i cili është shquar me saktësi dhe precizitet në shkencën e hadithit në aspektin e pranimin të transmetimeve nga të besueshmit dhe refuzimit të tyre nga të pabesueshmit, ka sjellë provën e pakontestueshme kundrejt të gjithë atyre që e anashkalojnë dhe e braktisin këtë sunet. Kjo, për t'ua bërë me dije atyre se janë duke lënë anash një sunet që na e kanë përcjellë të përgëzuarit me Xhenet, dijetarët e sahabëve dhe dijetarët e brezave të parë të mbarë që e përcollën brez pas brezi dhe e llogaritnin stoli të namazit, madje ua tërhiqnin vërejtjen atyre që nuk e praktikonin.

Ky libër është hallka kryesore për kuptimin e kësaj tematike, prandaj i thurim lavde dhe falënderime Allahut Lavdiplotë që e ka bërë të mundur që kjo perlë t'i ofrohet edhe lexuesit shqipfolës, gjë e cila do të kontribuojë në vetëdijesimin e falësve të namazit për rëndësinë dhe vlerën e kësaj praktike të Pejgamberit të njerëzimit ﷺ. Në këtë vazhdë e lus Allahun Bujar ta shpërblejë me të mirat e Tij hoxhë Adnan Nikezin për këtë përkthim, si dhe jam mirënjohës ndaj tij që më dha rastin të shkruaj disa fjalë rreth vlerës dhe rëndësisë se këtij libri.

E lus Allahun të na udhëzojë në praktikimin e Sunetit të Pejgamberit ﷺ dhe të na mundësojë të jemi kandilë ndriçues që, ngado që shkojnë, reflektojnë mësimet e të Dërguarit tonë fisnik, Muhamedit ﷺ.

Allahu e di më së miri.

Hoxhë Bajram Karabeg

30.01.2023, Prishtinë

NGRITJA E DUARVE
(PARA DHE PAS RUKUSË)
NË NAMAZ

Imam Buhariu

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Imam Ebu Abdullah Muhamed ibn Ismail ibn Ibrahim el Buhariu ka thënë:

Kjo është kundërpërgjigja ndaj atyre që mohojnë ngritjen e duarve në namaz para rukusë dhe pas ngritjes së kokës nga rukuja, duke u përpjekur me këmbëngulje dhe duke hyrë në gjëra që nuk duhen lënë në paqartësi jorabët¹, për atë që është vërtetuar me fjalë dhe praktikë nga i Dërguari i Allahut ﷺ, dhe fjalët e praktika e shokëve të tij, që është transmetuar nga ata, pastaj praktika e tabiinëve, duke i marrë për shembull selefët – paraardhësit, dhe

¹ Disa kanë thënë se Buhariu me këtë ka pasur për qëllim hanefinjte që jetonin “bilad ma vera en-Nehr”, ku bëjnë pjesë: Uzbekistani, Tashkistani, një pjesë e Kirgistanit dhe Kazakistanit. Edhe indianët quhen axhemë – të huaj, edhe nëse të gjithë këta flasin gjuhën arabe.

Është thënë se imam Buhariu me këtë ka pasur për qëllim fukahatë, të cilët u treguan të ngurtë në atë që trashëguan nga imamët e tyre duke mos shikuar fare në tekstet sheriatike, kështu që ata në këtë janë sikurse axhemët që nuk kuptojnë vetëm se atë që trashëguan nga imami i tyre. Edhe sikur t’u tregoje hadithe dhe praktikën e sahabëve për këtë, ata nuk do të vepronin me të. Sh. p.

duke ndjekur autenticitetin e haditheve që janë vërtetuar brez pas brezi nga të besueshmit te të besueshmit e deri tek ata që kanë ardhur më pas. Allahu i mëshiroftë dhe i shpërbleftë me atë që ua ka premtuar!

Ai i cili refuzon (t'i ngrëjë duart) tregon inat nga gjoksi dhe shqetësim nga zemra, duke refuzuar sunetet e të Dërguarit të Allahut ﷺ dhe mendjemadhësi e armiqtësi ndaj pasuesve të Sunetit! Të tillit i është përzier bidati me mishin, trurin dhe eshtrat, kështu që i gjori u mashtrua dhe gjeti ngrohësi te joarabët që u mblodhën rreth tij.

Pejgamberi ﷺ thotë: **“Vazhdimisht do të jetë një grup nga umeti im në të vërtetën. Ata nuk do të dëmtohen nga ata që i tradhtojnë e as nga ata që i kundërshtojnë.”**

Kështu, ata vazhdimisht do të ndjekin Sunetin e Pejgamberit ﷺ, duke i ngjallur ato sunete të cilat kanë vdekur, edhe nëse kanë ndonjë mangësi pas dëshirës dhe nijetit të sinqertë (pa dashur të kundërshtojnë Sunetin, se në këtë rast u falet), dhe se ata me këtë dëshiruan të ndjekin si shembull Pejgamberin ﷺ, për shkak se të gjitha krijesat janë të urdhëruara të ndjekin veprimet e të Dërguarit të Allahut ﷺ që ai i ka vepruar e të largohen nga ato gjëra për të cilat ai ka paralajmëruar, si dhe të zbatojnë ato të cilat na i ka urdhëruar, sepse Allahu për atë (besimin në të Dërguarin) i obligoi krijesat që ta pasojnë e t'i nënshtrohen. Allahu e konsideroi ndjekjen dhe nënshttrimin ndaj të Dërguarit si nënshttrim ndaj të Lartësuarit. I Madhëruari thotë:

“... çfarëdo që t’ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t’ju ndalojë, hiqni dorë prej saj...” (El Hashr, 7)

“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut...” (En Nisa, 80)

“Jo, për Zotin tënd, ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë, derisa të të marrin ty për gjyqtar për kundërshtitë mes tyre, e pastaj, të mos ndiejnë kurrfarë dyshimi ndaj gjykimit tënd dhe të të binden plotësisht.” (En Nisa, 65)

“Le të frikësohen ata që kundërshtojnë urdhrin e tij (Pejgamberit), që të mos i arrijë ndonjë sprovë ose që të mos i godasë një dënim i dhembshëm!” (En Nur, 63)

“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë që shpreson tek Allahu e Dita e Fundit dhe përmend shumë Allahun.” (El Ahzab, 21)

Allahu e mëshiroftë atë rob që nëpërmjet ndjekjes së Sunetit dhe rrugës së të Dërguarit të Allahut ﷺ kërkon ndihmë nga Allahu. Allahu i Madhëruar e ruajttë nga sherri i nefsit të tij dhe e drejtoftë në rrugën e drejtë! I Madhëruari thotë: “... **kush do ta pasojë udhëzimin Tim, as do të humbë, as do të bjerë në mjerim.**” (Taha, 123)

Hadithi 1

Na ka treguar Ismail ibn Ebu Uvejsi, më ka treguar Abdurrahman ibn Ebu Zinadi nga Musa ibn

Ukbe, e ky nga Abdullah ibn Fadl el Hashimi, e ky nga Abdurrahman ibn Hurmuz el Arexhi, e ky nga Ubejdullah ibn Ebi Rafiu, e ky nga Ali ibn Ebu Talibi (radijallahu anhu): **“I Dërguari i Allahut ﷺ i ngrinte duart në lartësi të supeve kur merrte tekbinin për namaz, kur dëshironte të përkulej në ruku dhe kur e ngrinte kokën nga rukuja, e edhe kur ngrihej nga rekati i dytë vepronte njëjtë.”**¹

Imam Buhariu (Allahu e mëshiroftë!) thotë: “Gjithashtu transmetohet nga shtatëmbëdhjetë sahabët e të Dërguarit të Allahut ﷺ se i kanë ngritur duart kur përkuleshin dhe kur ngriheshin nga rukuja, ndër të cilët janë:

- 1- Ebu Katade el Ensari,
- 2- Ebu Usejd es Said el Bedri,
- 3- Muhamed ibn Mesleme el Bedri,
- 4- Sehl ibn Sad es Saidi,

¹ Zinxhiri i transmetimit është hasen (i mirë). Gjithashtu këtë hadith e shënon Ahmedi në “Musned” (717), Tirmidhiu (3423), i cili thotë: “Hasen-sahih”, Ibn Huzejme (1/294), Ebu Davudi (744). Imam Ahmedi dhe të tjerët e kanë konsideruar hadithin të vërtetë.

- 5- Abdullah ibn Omer ibn Hatabi,
- 6- Abdullah ibn Abas ibn Abdulmutalib el Hashimi,
- 7- Enes ibn Maliku, shërbëtori i Dërguarit të Allahut,
- 8- Ebu Hurejre ed Deusi,
- 9- Abdullah ibn Amër ibn Asi,
- 10- Abdullah ibn Zubejr ibn el Avam el Kureshi,
- 11- Vail ibn Huxhr el Hadremi,
- 12- Malik ibn Huvejrithi,
- 13- Ebu Musa el Eshari,
- 14- Ebu Humejd es Sadi el Ensari,
- 15- Omer ibn Hatabi,
- 16- Ali ibn Abdulmutalibi, dhe
- 17- Umu Derdai (Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë!).

El Hasen dhe Humejd ibn Hilal kanë thënë: **“Shokët e të Dërguarit të Allahut ﷺ i ngrinin duart e tyre.”**

Këta dy sahabë nuk përjashtuan asnjë prej shokëve të të Dërguarit ﷺ dhe nuk është vërtetuar (asnjë hadith) te dijetarët se shokët e Pejgamberit nuk i kanë ngritur duart (para dhe pas rukusë).

Po ashtu kemi përmendur se ngritja e duarve është transmetuar nga një grup i madh i shokëve të Pejgamberit ﷺ. Gjithashtu është transmetuar nga një grup i madh i dijetarëve të Mekës, Hixhazit,

NGRITJA E DUARVE (PARA DHE PAS RUKUSË) NË NAMAZ

Irakut, Shamit, Basrës, Jemenit, e edhe nga një grup i madh i dijetarëve të Horosanit, ndër të cilët janë:

- 1- Seid ibn Xhubejri
- 2- Ata ibn Ebi Rebahu,
- 3- Muxhahidi,
- 4- El Kasim ibn Muhamedi,
- 5- Salim ibn Abdullah ibn Abdullah ibn Omer el Hatabi,
- 6- Omer ibn Abdulazizi,
- 7- Numan ibn Ebu Ajashi,
- 8- El Haseni (el Basri)
- 9- Ibn Sirini,
- 10- Tavusi,
- 11- Mekhuli,
- 12- Abdullah ibn Dinari,
- 13- Nafiu,
- 14- Ubejdullah ibn Omeri,
- 15- El Hasen ibn Muslimi
- 16- Kajs ibn Sadi, dhe shumë të tjerë.

Gjithashtu transmetohet nga Umu Derdai se ajo i ka ngritur duart.

Edhe Abdullah ibn Mubareku i ka ngritur duart dhe shumica e nxënësve të Ibn Mubarekut, ndër të cilët janë: Ali ibn el Haseni,

Abdullah ibn Othmani, Jahja ibn Jahjai, dhe muhadithët e Buharës, si: Isa ibn Musai, Kab ibn Saidi, Muhamed ibn Selami, Abdullah ibn Muhamed el Musnidi dhe shumë të tjerë që nuk mund të numërohen. Nuk ka pasur mospajttime mes tyre (në lidhje me ngritjen e duarve).

Abdullah ibn Zubejri, Ali ibn Abdullahu (el Medini), Jahja ibn Meini, Ahmed ibn Hanbeli, Ishak ibn Ibrahim (er Rahuje) i kanë vërtetuar dhe i kanë konsideruar të sakta të gjitha hadithet që janë transmetuar nga i Dërguari i Allahut, të cilët ishin dijetarët më të mëdhenj të kohës.

Po ashtu kjo është transmetuar edhe nga Abdullah ibn Omer ibn Hatabi.

Hadithi 2

Na ka treguar Ali ibn Abdullahu, na ka treguar Sufjani (Ibn Ujejne), na ka treguar Zuhriu nga Salim ibn Abdullah, e ky nga babai i tij (Abdullah ibn Omeri) se ka thënë: **“E kam parë Pejgamberin ﷺ duke i ngritur duart kur mernte tekbirin dhe kur përkulej në ruku, kur e ngrinte kokën nga rukuja, gjë të cilën nuk e bënte në mes të dy sexhdeve.”**¹

Alij ibn Abdullahu (el Medini), që ishte nga më të diturit e kohës së tij, ka thënë: **“Ngritja e duarve është hak që duhet pasuar nga muslimanët, për shkak të transmetimit që e përcjell Zuhriu nga Salim e ai nga Abdullahu.”**²

¹ Ky transmetim është i saktë pa asnjëfarë dyshimi. Imam Muslimi, Tirmidhiu dhe të tjerët e kanë konsideruar të saktë. Imam Ibn Abdulberri ka thënë: “Nuk ka asnjë kritikë (nga ana e muhadithëve) për këtë hadith!” Shiko: “El-Istidhkar.” Transmetuesi i hadithit: Ali ibn Abdullah el Medini konsiderohet një nga imamët më të mëdhenj të ehli sunetit dhe është ndër transmetuesit më të saktë në transmetim të hadithit. Disa gënjeshtarë të kësaj kohe thonë se ka qenë shiit, që është një gënjeshtër absolute. Hafidh Dhehebiu në veprën e tij “Mizan el-itidal” shkëlqyeshëm e ka mbrojtur imam el Medinin dhe të gjitha kritikët që janë dedikuar atij i ka hedhur poshtë e i ka konsideruar të papranuara. Falënderimi i takon Allahut.

² Ali ibn Medini njëherë i tha Ebu Velid et Tajalisit: “Cili është justifikim yt dhe çfarë do të sjellësh si dëshmi kur të qëndrosh para Allahut, për braktisjen e mosngritjes së duarve para dhe pas rukusë?!” Pas kësaj Ebu Velidi filloi të ngrej duart në namaz, pasi i kishte kaluar tetëdhjetë vjet pa i ngritur.” (“Tarikh el Islam”, 5/719). Sh. p.

Hadithi 3

Na ka treguar Musededi, na ka treguar Jahja ibn Seidi, na ka treguar Abdulhamid ibn Xhaferi, na ka treguar Muhamed ibn Amri duke thënë: **“E kam parë Ebu Humejdin duke treguar në prani të dhjetë sahabëve të Pejgamberit ﷺ, - njëri ndër të cilët ishte Ebu Katade ibn Rebiu, - duke thënë: “Unë di më mirë për namazin e të Dërguarit ﷺ.” Ata i thanë: “Na trego, se për Allahun as ke kaluar më shumë kohë duke u shoqëruar me të e as e ke pasuar më shumë se ne!” Ai i tha: “Vërtet e kam vështuar kur e ka falur namazin.” Ata i thanë: “Atëherë na e përshkruaj!” Ai tha: “Ai, kur ngrihej për namaz, i ngrinte duart, e ashtu vepronte edhe kur përkulej në ruku, edhe kur e ngrinte kokën nga rukuja. Edhe kur ngrihej pas dy rekateve e vepronte të njëjtën gjë.”¹**

Imam Buhariu ka thënë: “E kam pyetur Ebu Asimin për hadithin e Abdulhamid ibn Xhaferit, e edhe ai e vërtetoi.

Më ka treguar Abdullah ibn Muhamedi nga Abdulhamid ibn Xhaferi se ka thënë: “Më ka treguar Muhamed ibn Amër ibn Atai

¹ Ky hadith është i saktë. Të tillë e ka vlerësuar imam Ibn Huzejme, Ibn Hibani, Ibn Xharudi, Tirmidhiu dhe Ibn Tejmije (Allahu i mëshiroftë të gjithë!).

Abdulhamid ibn Xhaferi është njëri nga transmetuesit në “Sahih Muslim”, i përpiktë dhe i besueshëm sipas shumicës së dijetarëve të hadithit. Me këtë është pajtuar edhe ez Zejlai el Hanefi (“Nasbu er-Raje”, 344/10).

se ka thënë: **“Kam qenë prezent kur Ebu Humejdi, në prani të dhjetë shokëve të Pejgamberit ﷺ, - njëri ndër të cilët ishte edhe Ebu Katade ibn Rebiu, - duke thënë: “Unë di më mirë për namazin e të Dërguarit të Allahut ﷺ”, dhe përmendi të njëjtën gjë. Të gjithë që ishin prezent thanë: “Të vërtetën e the.”¹**

¹ Vërejtje: Disa në bazën e këtij hadithi që e transmeton Ebu Humejd es Saïdi, të cilin e ka shënuar Buhariu në “Sahih”, ku nuk përmendet ngritja e duarve, e marrin si argument se duart nuk duhet të ngrihen. Përgjigjja për këtë është se mospërmendja e diçkaje nuk mund të jetë argument në lidhje me atë që është përmendur (se duart ngrihen), kështu që kritika që i bëhet hadithit që tregon për ngritjen e duarve, duke u argumentuar me një transmetimin të Buhariut në “Sahih” që nuk e ka përmendur, nuk është e saktë.

Hadithi 4

Na ka treguar Abdullah ibn Muhamedi, na ka treguar Abdulmelik ibn Amri, na ka treguar Fulejh ibn Sulejmani, na ka treguar Abas ibn Sehli, i cili ka thënë: “Ishin mbledhur Ebu Humejdi, Ebu Usejdi, Sehl ibn Sadi dhe Muhamed ibn Mesleme dhe përmendën namazin e Pejgamberit ﷺ.” Ebu Humejdi tha: **“Unë di më mirë për namazin e të Dërguarit të Allahut (sal-lallahu alejhiu ve selem). Ai, kur ngrihej për namaz, merrte tekbir dhe i ngrinte duart, pastaj i ngrinte duart kur merrte tekbirin për të rënë në ruku, pastaj binte në ruku dhe i vendoste duart në gjunjë.”**¹

¹ Zinxhiri i transmetimit është i mirë. Të saktë e kanë vlerësuar Ibn Huzejme (589, 608, 640, 689), Ibn Hibani (494) dhe Tirmidhiu (260).

Muhamed ibn Jahja edh Dhuli ka thënë: “Ai që e dëgjon këtë hadith dhe, pas kësaj, nuk i ngre duart e tij para dhe pas rukusë, namazi i tij nuk është i plotë!”

Hadithi 5

Na ka treguar Ubjed ibn Jeishi, na ka treguar Junus ibn Bukejri, na ka treguar Ibn Ishaku nga el Abas ibn Sehl es Saidi, se ka thënë: “Isha në treg me Ebu Kataden, Ebu Usejdin dhe Ebu Humejdin dhe të gjithë thoshin: “Unë di më mirë për namazin e të Dërguarit të Allahut ﷺ”, kështu që i thanë njërit prej tyre që ta falë namazin dhe ai: **“Mori tekbirin, pastaj lexoi diçka nga Kurani e i ngriti (duart). Dy prej tyre thanë: “U fale ashtu siç është falur i Dërguari i Allahut ﷺ.”**”¹

¹ Ky transmetim është hasen - i mirë.

Ibn Ishaku është “mudelis” (që përdor manipulime gjatë transmetimit të hadithit), mirëpo ai në këtë hadith ka vërtetuar se e ka dëgjuar nga mësuesi i tij, tek Ibn Huzejme në librin e tij “Sahih”.

Hadithi 6

Na ka treguar Ebu el Velid Hisham ibn Abdulmeliku dhe Sulejman ibn Harbi dhe të dy kanë thënë se na ka treguar Shube nga Katadja, e ky nga Nasr ibn Asimi, e ky nga Malik ibn el Huvejrithi se ka thënë: **“Kur i Dërguari i Allahut ﷺ merрте tekbirin, i ngrinte duart, e edhe kur binte në ruku e kur e ngrinte kokën nga rukuja.”**¹

¹ Zinxhiri i transmetimit është i saktë. Imam Muslimi e shënon në librin e tij “Sahih”, numër 66.

Vërejtja e parë: Është vërtetuar në dy librat e saktë, te Buhariu dhe Muslimi, se tabiini Ebu Kilabe (që konsiderohet i besueshëm) e ka parë Malik ibn el Huvejrithin (pas vdekjes së Pejgamberit ﷺ) duke ngritur duart para dhe pas rukurës.

Vërejtja e dytë: Pretendimi se Ebu Kilabe e ka përbuzur el Bejtin dhe Nasr ibn Asimin se ka pasur mendimet e havarixhëve nuk është vërtetuar dhe është i papranuar.

Vërejtja e tretë: Nuk është vërtetuar në asnjë hadith të saktë se Malik ibn el Huvejrithi i ka ngritur duart në sexhde. Transmetimi që e shënon Nesaiu në “Sunen” është i dobët, për shkak të tedlisit (manipulimit) të Katades. Këtë transmetim nga Katadja nuk e transmeton Shube, por Seid ibn Ebu Dunja. Shiko: “Sunenin e Nesaiut”, 672.

Hadithi 7

Na ka treguar Muhamed ibn Abdullah ibn Haushebi, na ka treguar Abdulvehabi, na ka treguar Humejdi nga Enesi (Allahu goftë i kënaqur me të!) se ka thënë: **“I Dërguari i Allahut ﷺ, kur binte në ruku, i ngrinte duart.”**¹

¹ Zinxhiri i transmetimit është i dobët, për shkak të tedlisit të Humejd et Tavilit, i cili është mudelis (manipulues) i njohur. Mirëpo, në “Musnedin” e Ebu Jalait ky transmetim është shënuar me fjalët e radhës: “E kam parë të Dërguarin e Allahut (sal-lallahu-alejhi ve selem), kur e filloi namazin, i ngriti duart, edhe para dhe pas rukusë.” Kështu, ky tekst i hadithit është vërtetuar nga transmetuesit e tjerë, atëherë hadithi i Humejd et Tavilit me këto fjalë e tekst (të hadithit) dhe “shevahid” dëshmime të tjera është i saktë. Falënderimi i takon Allahut.

Vërejtje: Abdulvehab eth Thekafiu konsiderohet i përpiktë dhe i besueshëm të shumica e muhadithëve. Prandaj, edhe nëse është i vetëm në përcjellje të hadithit, hadithi i tij konsiderohet sahih ose hasen.

Hadithi 8

Na ka treguar Ismail ibn Ebi Uvejsi, na ka treguar Ibn Ebu ez Zinadi nga Musa ibn Ukbe, e ky nga Abdullah ibn el Fadli, e ky nga Abdurrahman ibn Hurmuz el Arexhi, e ky nga Ubejdullah ibn Ebu Rafiu, e ky nga Ali ibn Ebu Talibi (Allahu qoftë i kënaqur me të!): **“Kur i Dërguari i Allahut ﷺ ngrihej për të falur namazin e detyruar, merrte tekbirin dhe i ngrinte duart deri te supet e tij. Edhe kur dëshironte të binte në ruku ashtu vepronte, e edhe kur e ngrinte kokën nga rukuja. Kur rrinte ulur në namaz, nuk i ngrinte duart e tij e, kur ngrihej nga rekati i dytë, i ngrinte duart dhe e thoshte tekbirin.”**¹

¹ Ky hadith është i mirë.

Hadithi 9

Na ka treguar Ebu Nuajm el Fadl ibn Dukejni, na ka treguar Kajs ibn Muslim el Anberi duke thënë: “E kam dëgjuar Alkame ibn Vail ibn Huxhrin duke thënë: “Më ka treguar babai im, i cili ka thënë: **“Jam falur me Pejgamberin ﷺ. Kur ai e fillonte namazin, merrte tekbirin dhe i ngrinte duart, pastaj përsëri i ngrinte duart kur dëshironte të binte në ruku, e edhe pas rukusë.”**”¹

Imam Buhariu thotë: “Ebu Bekër en Nehsheli e transmeton nga Asim ibn Kulejbi, e ky nga babai i tij, se Aliu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) i ngrinte duart në tekbirin fillestar, e pas kësaj here nuk i ngrinte më.”²

Megjithatë, hadithi që transmeton Ubejdullahu (që tregon për ngritjen e duarve) është më i saktë, edhe pse hadithi që transmeton Kulejbi tregon se nuk i ka ngritur duart, për shkak se Kulejbi nuk e

¹ Zinxhiri i transmetimit është i saktë. Këtë hadith gjithashtu e shënon Nesaiu nga Kajs ibn Salimi.

² Ky transmetim te dijetarët e hadithit është i dobët e i pavërtetuar. Imam Shafiu (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: “Kjo nuk është e vërtetuar!” (“Sunen el-Bejheki”, 81/2) Gjithashtu imam ed Darimi dhe të tjerët e kanë kritikuar (këtë transmetim). Prandaj verifikimi i këtij transmetimi nga ana e disa fanatikëve nuk është i saktë. Është më se e qartë se dijetarët e hadithit e dinë më mirë saktësinë dhe dobësinë e transmetimeve se kushdo tjetër.

ka mbajtur në mend ngritjen e duarve, kështu që hadithi i Ubejdullahut merret si dëshmi për këtë.

Nëse dy transmetues transmetojnë nga muhadithi, e njëri prej tyre thotë: “E kam parë duke vepruar kështu...”, ndërsa tjetri thotë: “Nuk e kam parë duke vepruar kështu...”, atëherë ai që thotë: “E kam parë duke vepruar kështu...” tregon se vetë ka dëshmuar për këtë, ndërsa ai që thotë: “Nuk e kam parë duke vepruar kështu...” tregon se ai nuk është dëshmitar për këtë, sepse ai nuk ka mbajtur në mend një veprim të tillë.

Gjithashtu (kështu ka vepruar) Abdullah ibn Zubejri me dy dëshmitarë, kur dëshmuar para tij:

“Filani i ka borxh filanit një mijë derhemë.” Dy dëshmitarët e tjerë thanë: “Filani nuk i ka borxh askujt!” Atëherë Abdullah ibn Zubejri e pranoi dëshminë e këtyre dy personave, ndërsa tjetrit nuk ia pranoi.

Njëjtë ka thënë edhe Bilali: “E kam parë Pejgamberin ﷺ duke u falur në

Qabe, ndërsa Fadl ibn Abasi ka thënë: “Ai nuk është falur në Qabe!” Njerëzit e pranuan fjalën e Bilalit, për shkak se ai ishte dëshmitar vetë për këtë dhe nuk e morën parasysh fjalën e atyre që thanë se ai nuk është falur në Qabe, për shkak se ai nuk e kishte mbajtur në mend.

NGRITJA E DUARVE (PARA DHE PAS RUKUSË) NË NAMAZ

Abdurrahman ibn Mehdiu ka thënë: “I përmenda Sufjan eth Theuriut hadithin e Nehsheliut që e transmeton nga Asim ibn Kulejbi, e ai e refuzoi!”

Hadithi 10

Na ka treguar Abdullah ibn Jusufi, na ka treguar Maliku, e ky nga Ibn Shihabi, e ky nga Salim ibn Abdullahu, e ky nga babai i tij (Abdullah ibn Omeri) se ka thënë: **“I Dërguari i Allahut ﷺ, kur e fillonte namazin, i ngrinte duart deri te supet e tij, e edhe kur përkulej në ruku merrte tekbir e i ngrinte duart. Edhe kur e ngrinte kokën nga rukuja i ngrinte duart, por ai nuk e bënte këtë në sexhde.”**¹

¹ Ky transmetim është i shënuar në “Sahihun” e Buhariut, 735.

Pothuajse me të njëjtin kuptim e kemi transmetimin e ngjashëm të “Muveta” e imam Malikut (të cilin e transmetojnë Ibn Kasimi dhe Muhamed ibn Shejbani).

Vërejtja e parë: Kundërshtimi për ngritjen e duarve nuk është vërtetuar nga imam Maliku në asnjë transmetim të saktë. “El-Mudevenatu-l-kubra” nuk është e saktë, është e transmetuar pa zinxhir.

Vërejtja e dytë: “Ngritja e duarve është vërtetuar nga imam Maliku, në shumë zinxhirë të saktë, sikurse te libri: “Temhid”.

Hadithi 11

Na ka treguar Ejub ibn Sulejmani, na ka treguar Ebu Bekër ibn Ebu Uvejsi, e ky nga Sulejman ibn Bilali, e ky nga el Alai se e ka dëgjuar Salim ibn Abdullahun duke thënë: **“Babai im (Abdullah ibn Omeri), kur e ngrinte kokën nga sexhdeja dhe dëshironte të ngrihej në këmbë, i ngrinte duart e tij.”**¹

¹ Zinxhiri i transmetimit është i saktë.

Hadithi 12

Na ka treguar Abdullah ibn Salihu, na ka treguar Lejthiu, më ka treguar Nafiu se: **“Abdullah ibn Omeri, kur e fillonte namazin, i ngrinte duart e tij. Ashtu vepronte edhe kur binte në ruku, dhe kur e ngrinte kokën nga rukuja, e edhe kur ngrihej pas rekatis të dytë nga sexhdeja merrte tekbir dhe i ngrinte duart.”**¹

¹ Ky hadith është i saktë.

Hadithi 13

Na ka treguar Humejdi, na ka treguar Velid ibn Muslimi, i cili ka thënë: “E kam dëgjuar Zejd ibn

Vakidin duke treguar se e ka dëgjuar Nafiun duke thënë: **“Ibn Omeri, kur shihte një njeri që nuk i ngrinte duart kur përkulej dhe kur ngrihej nga rukuja, e gjuante me guralecë!”**¹

Imam Buhariu ka thënë: “Transmetohet nga Ebu Bekër ibn Ajashi, e ky nga Husajni, e ky nga Muxhahidi: **“E kam parë Ibn Omerin duke i ngritur duart vetëm në tekbirin fillestar.”**

Dijetarët kanë transmetuar nga ai se nuk mbahet në mend se ai nuk i ka ngritur duart, përveç nëse ka ndodhur që Ibn Omeri të ketë harruar (të ngrinte duart), siç ndodh që njeriu të harrojë diçka nga namazi, siç i ka ndodhur një herë Ibn Omerit të harrojë të

¹ Zinxhiri i transmetimit është i saktë. Imam Neveviu e ka konsideruar të saktë këtë hadith në librin e tij “El-Mexhua”, (3/405).

Imam Darekutni thotë: “Na ka treguar Ebu Bekër Nejsaburi, na ka treguar Isa ibn Ebu Imrani, na ka treguar Velid ibn Muslimi, na ka treguar Zejd ibn Vakidi, e ky nga Nafiun, se ai ka thënë: “Ibn Omeri, kur e shihte njeriun duke u falur dhe nuk i ngrinte duart sa herë që përkulej dhe ngrihej nga rukuja, e gjuante me guralecë derisa t’i ngrinte duart!” Ndërkaq, imam Hakimi shton: “Dhe e urdhëronte që t’i ngrinte duart e tij.” Sh. p. Nga ky hadith shohim se sulmi ndaj atij që kundërshton Sunetin është i lejuar. Megjithatë, atë gjë mund ta bëjnë vetëm përfaqësuesit në qeverisjen islame, sikur në këtë rast ishte Ibn Omeri. Allahu qoftë i kënaqur me të!

lexojë Kuran në namaz, si dhe siç u ka ndodhur shokëve të Pejgamberit ﷺ që të harrojnë në namaz, duke dhënë selam pas rekatit të dytë ose të tretë.

A nuk dëshmon fakti se Ibn Omeri i gjuante me guralecë njerëzit që nuk i ngrinin duart e tyre në namaz? Atëherë, si ka mundësi që Ibn Omeri të braktisë një sunet për të cilin ai vetë urdhëronte e i mësonte të tjerët, si dhe vetë e kishte parë Pejgamberin ﷺ duke e vepruar?!¹

Jahja ibn Meini thotë: “Hadithi që transmeton Ebu Bekri nga Husejni është gabim dhe dyshim nga ai që nuk ka bazë!”²

Na ka treguar Muhamed ibn Jusufi, na ka treguar Abdul el Ala ibn Mushiri, na ka treguar Abdullah ibn el Ala ibn Zebri, na ka treguar Amër ibn Muhaxhiri, se ai ka thënë: “Abdullah ibn Amri

¹ Gjithë fjalimi që përmendi imam Buhariu është vetëm në teori se, në parim, ky hadith që e transmeton Ebu Bekër ibn Ajashi është i refuzuar, sipas asaj që ka thënë imam Jahja ibn Meini dhe Ahmed ibn Hanbeli. Për më shumë informacion për këtë hadith, shiko librin: “Nurul-ajnejni fi ithbat ref’ul jedejn” (131,136).

² Imam Ahmed ibn Hanbeli për këtë hadith ka thënë: “Ai është hadith batil - i kotë!” (“Mesail Ibn Hani”, 1/50).

Ebu Bekër ibn Ajashi është transmetues i dobët në hadith, për shkak të memories së tij të dobët. Në librin e Buhariut “Sahih” të gjitha transmetimet e tij varen nga “mutabat dhe shevahid” (që do të thotë se të gjitha hadithet e tij që gjenden te Buhariu në “Sahih” janë të sakta për shkak të përputhjeve dhe dëshmimeve të transmetimeve të tjera).

Ima Ebu Nuajm el Fadl ibn Dukejn el Kufi ka thënë: “Në mesin e mësuesve tanë askush nuk gabon më shumë se Ebu Bekër ibn Ajashi.” (“Tarikh Bagdad”, 14/378), zinxhiri i transmetimit është i saktë.

më ka pyetur për ta çuar te (kalifi) Omer ibn Abdulazizi. Pasi që mora leje, ai (Omer ibn Abdulazizi) më tha: **“More, a nuk është (Abdullah ibn Amri) ai që e godet vëllanë e tij për shkak se nuk i ngre duart e tij? Vërtet kur ishim të vegjël në Medinë na edukonin dhe na mësonin për t’i ngritur duart.” Kështu ai nuk i dha leje (që të vijë).”**¹

Imam Buhariu thotë: “Zaide (ibn Kudame) u transmetonte hadithe vetëm pasuesve të Sunetit, duke ndjekur kështu selefët.”²

Një grup i murxhinjve nga Belhu vajtën te Muhamed ibn Jusufi (një nga mësuesit e mëdhenj të Buhariut) në Sham, ndërsa Muhamedi deshi t’i përzëre e t’i nxjerrë nga vendi, derisa të

¹ Zinxhiri i transmetimit është i saktë.

Nuk i dha leje Abdullah ibn Amrit, për shkak se braktisi sunetin e ngritjes së duarve, e ky është ndëshkimi për atë që braktis Sunetin.

Bejhekiu në “El-Hilafijat” transmeton nga kalifi Omer ibn Abdulazizi se disa njerëz i thanë: “Ata e ndalojnë ngritjen e duarve në namaz.” Ai tha: “Po ta prisja dorën, do ta ngrija krahun dhe, po ta prisja krahun, do ta ngrija krahun sipër.” Sh. p.

² Ai është Ebu Salt Zaide ibn Kudame eth Thekafi (161 h), i besueshëm dhe dijetar i Sunetit dhe hafidh i haditheve, askujt nuk i ka treguar hadithe pa pyetur për të: nëse ka qenë pasues i Sunetit, i ka treguar hadithe, përndryshe jo. Ebu Davud Tajalisi ka thënë: “Ai nuk u tregonte hadithe pasuesve të bidatit.” Sh. p.\

Omer ibn Abdulazizi ka thënë: “Kur ishim në Medinë, nëse nuk i ngrinin duart në namaz, na edukonin për të.” Transmetohet nga Neufel ibn Musahiku se ka thënë: “I përmendën Omer ibn Abdulazizit se Salim i ngrinte duart në namaz. Ai tha: “A mendoni se Salimi nuk e ka mbajtur në mend këtë sunet nga babai i tij? A mendoni se babai i tij nuk e ka mbajtur në mend këtë sunet nga Pejgamberi ﷺ!” Shiko: “Temhid” nga Ibn Abdulberri (9/219). Sh. p.

pendohen nga (ai bidat) dhe të kthehen në rrugën e drejtë të Sunetit.

Ne kemi parë shumë dijetarë se si përpiqeshin që t'i sillnin pasuesit e bidatit që të pendoheshin, në të kundërtën i përzinin nga mexhliet e tyre.

Abdullah ibn Zubejri i tha Sulejman ibn Harbit (të dy kanë qenë mësuesit e Buhariut), i cili në atë kohë ishte kadi në Mekë, që t'i pengojë e të mos lejojë disa pasues të ehlu rejit (pasues të analogjisë), e ai ashtu bëri, kështu që ata nuk mundnin të jepnin fetva, derisa dolën nga Meka.

Hadithi 14

Na ka treguar Malik ibn Ismaili, na ka treguar Sheriku, e ky nga Lejthiu, e ky nga Atai se ka thënë: **“E kam parë Ibn Abasin, Ibn Zubejrin, Ebu Seidin dhe Xhabirin duke i ngritur duart kur e hapnin namazin dhe kur përkuleshin në ruku.”**¹

¹ Hadithi është hasen - i mirë. Zinxhiri i transmetimit është i dobët për shkak të Sherikut dhe Lejthiut, mirëpo ngritja e duarve është vërtetuar nga Ibn Zubejri dhe Ibn Abasi te “Suneni i Bejhekiut” (73/2). Transmetimi nga Xhabiri gjendet tek Ibn Maxhe në “Sunen” dhe “Musned” të Siraxhit, me zinxhir të saktë. Po ashtu është vërtetuar nga Seid ibn Xhubejri, se sahabinu i nderuar Ebu Seid i ka ngritur duart para dhe pas rukusë. (“El-Bejheki”, 75/2). Kështu, për shkak të këtyre dëshmimeve, hadithi është hasen - i mirë.

Vërejtje: E kundërta për mosngritjen e duarve nuk vërtetohet nga Ibn Omeri dhe Ebu Seidi. Në zinxhirin e hadithit që thotë se ata nuk i kanë ngritur duart gjendet Atije el Afi, që është i dobët, shiit dhe mudelis. Shiko: “Tehdhib et-Tehdhib” dhe librat e tjerë.

Hadithi 15

Na ka treguar Muhamed ibn Salti, na ka treguar Ebu Shihab Abdurrabihu, e ky nga Muhamed ibn Ishaku, e ky nga Abdurrahman el Arexhi, e ky nga Ebu Hurejra: **“Se ai, kur merrte tekbirin fillestar, i ngrinte duart, e edhe kur shkante në ruku dhe kur e ngrinte kokën nga rukuja.”**¹

¹ Hadithi është sahih. Zinxhiri i transmetimit është i dobët për shkak të tedlisit të Muhamed ibn Ishakut, por hadithi i 18-të është dëshmi, kështu që ky hadith bëhet sahih.

Hadithi 16

Na ka treguar Musededi, na ka treguar Abdulvahid ibn Zijadi, e ky nga Asim el Ahveli, i cili ka thënë: **“E kam parë Enes ibn Malikun (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se, kur e hapte namazin, merrte tekbin dhe i ngrinte duart. Sa herë që binte në ruku dhe ngrinte kokën e tij nga rukuja, i ngrinte duart.”**¹

¹ Zinxhiri i transmetimit është i saktë.

Hadithi 17

Na ka treguar Musededi, na ka treguar Hushejmi nga Ebu Hamzai, i cili ka thënë: **“E kam parë Ibn Abasin duke i ngritur duart kur merrte tekbir dhe kur e ngrinte kokën e tij nga rukuja.”**¹

¹ Hadithi është i saktë.

Hushejm ibn Beshiri është mudelis, mirëpo është vërtetuar se ka dëgjuar nga Ebu Hamzai në vend tjetër.

Ebu Hamza ibn Ebu Atai është transmetues i përpiktë dhe i besueshëm, sipas shumicës së dijetarëve të hadithit, e hadithet që ai përcjell gjenden tek imam Muslimi në “Sahih”, kështu që zinxhiri i tij është i mirë. Shiko dëshminë për këtë hadith në librin “Nurul-ajnejn”, 125.

Hadithi 18

Na ka treguar Sulejman ibn Harbi, na ka treguar Jezid ibn Ibrahim, e ky nga Kajs ibn Sadi, e ky nga Atai se ka thënë: **“Jam falur me Ebu Hurejrën: ai i ngrinte duart kur merrte tekbirin dhe kur shkante në ruku.”**¹

¹ Zinxhiri i transmetimi është i saktë.

Hadithi 19

Na ka treguar Musededi, na ka treguar Halidi, na ka treguar Husajni, nga Amër ibn Murre, i cili ka thënë: “Kam prezantuar në xhaminë në Hadramaut (Jemen), ku Alkame ibn Vail transmetoi nga babai i tij se ai ka thënë: **“Pejgamberi ﷺ i ngrinte duart e tij para dhe pas rukusë.”**”¹

¹ Hadithi është sahih.

Hadithi 20

Na ka treguar Hatab ibn Othmani, e ky nga Ismaili, nga Abdurrabih ibn Sulejman ibn Umejri, i cili ka thënë: **“E kam parë Ummu Derdain duke i ngritur duart në namaz deri te supet e saj.”**¹

¹ Hadithi është i mirë. Po ashtu këtë transmetim e ka shënuar imam Buhariu në “Tarihu-l-Kebir” (6/78).

Hadithi 21

Na ka treguar Muhamed ibn Mukatili, na ka treguar Abdullah ibn Mubareku, na ka lajmëruar

Ismaili, më ka treguar Abdurrabih ibn Sulejman ibn Umejri, i cili ka thënë: **“E kam parë Ummu Derdain¹ duke i ngritur duart në namaz deri te supet kur e hapte namazin dhe kur shkante në ruku. Kur thoshte: “Semi’allahu li men hamideh”, ajo përsëri i ngrinte duart e dhe thoshte: “Rabbena ve lekel hamd.”**”²

Imam Buhariu ka thënë: “Disa gra të shokëve të Pejgamberit ﷺ ishin më të ditura se shumë prej atyre (që nuk i ngrinin duart), për shkak se ato i ngrinin duart e tyre në namaz.”

¹ Ummu Derda el Kubra, emri i saj është: Hajre bint Ebu Hadred el Esemi, ka qenë nga sahabet e ndershme, e mençur, e urtë dhe e zgjuar, e shkathët dhe njohëse e mirë e çështjeve, adhuruese e madhe, ka transmetuar hadithe nga Pejgamberi ﷺ dhe burri i saj, Ebu Derdai. Ebu Muhamed Ibn Hazmi e ka konsideruar prej fukahave të sahabëve që kanë dhënë fetva, ndërsa hafidh Ibn Abdulberri, Ibn Ethiri dhe Ibn Haxheri e kanë cilësuar me dituri dhe mençuri. Sh. p.

² Transmetimi është hasen - i mirë. Po ashtu këtë transmetim e ka shënuar imam Buhariu në “Tarihu-l-Kebir” (6/78).

Vërejtja e parë: Abdurrabih Ibn Hibani e ka konsideruar të besueshëm (7/153) dhe Muhamed ed Dimeshku në “Tarihu Dimeshk” (650).

Vërejtja e dytë: Transmetimet nga Ismail ibn Ajashi janë të besueshme kur transmeton nga mësuesit e tij nga Shami. Shiko: “Tehdhim et-Tehdhib” dhe veprat e tjera.

Hadithi 22

Na ka treguar Ishak ibn Ibrahim el Handhali, na ka treguar Muhamed ibn Fudajl nga Asim ibn Kulejbi, e ky nga Muharib ibn Dithari, i cili ka thënë: **“E kam parë Ibn Omerin duke i ngritur duart para se të shkonte në ruku, kështu që e pyeta për këtë, e ai më tha: “Kur i Dërguari i Allahut ﷺ, ngrihej nga rekati i dyte, bënte tekbir dhe i ngrinte duart.”**¹

¹ Zinxhiri i transmetimit është i saktë.

Hadithi 23

Na ka treguar Muslim ibn Ibrahim, na ka treguar Shube, na ka treguar Asim ibn Kulejbi, e ky nga babai i tij, e ky nga Vail ibn Huxhr el Hadrami (Allahu qoftë i kënaqur me të!): **“Se ai është falur me Pejgamberin ﷺ, kështu që, kur mori tekbir, i ngriti duart e tij dhe, kur deshi të shkojë në ruku, përsëri i ngriti duart.”**¹

Imam Buhariu ka thënë: “Transmetohet nga Omer ibn Hatabi (Allahu qoftë i kënaqur me të!), e ky nga Pejgamberi ﷺ dhe nga Xhabir ibn Abdullahu, e ky nga Pejgamberi ﷺ, dhe nga Ebu Hurejra, e ky nga Pejgamberi ﷺ, dhe nga Ubejd ibn Umejri, e ky nga babai i tij, e ky nga Pejgamberi ﷺ dhe nga Ibn Abasi, e ky nga Pejgamberi ﷺ, dhe nga Ebu Musai, e ky nga Pejgamberi ﷺ, se ai i ka ngritur duart e tij para se të shkonte në ruku dhe kur e ngrinte kokën nga rukuja.”²

Të gjitha këto që i kemi përmendur mjaftojnë për njeriun që kupton, në dashtë i Lartësuar.

¹ Zinxhiri i transmetimit është i saktë. Ibn Huzejme e ka konsideruar të saktë (687, 698).

² Verifikuesi i librit “Refu’l jedejni” të imam Buhariut, Bedrudin Rrashidi, i ka përmendur emrat e sahabëve që i kanë ngritur duart, numri i të cilëve arrin në njëzet e gjashtë sosh. (f. 72). Sh. p.

Hadithi 24

Na ka treguar Muhamed ibn Mukatili, na ka treguar Abdullahu nga Ibn Xhurejxhi duke lexuar para tij, i cili ka thënë: “Më ka informuar el Hasan ibn Muslimi, i cili thotë se e ka dëgjuar Tavusin duke u pyetur në lidhje me ngritjen e duarve në namaz, duke thënë: **“E kam parë Abdullahun, Abdullahun dhe Abdullahun, duke i ngritur duart e tyre. Ata kanë qenë: Abdullah ibn Omeri, Abdullah ibn Abasi dhe Abdullah ibn Zubejri.”**

Tavusi ka thënë: “Në tekbirin fillestar i ngrinin më shumë sesa në tekbiret e tjera.” (Ibn Xhurejxhi) thotë: “E kam pyetur Atain: “A të ka arritur se në tekbirin fillestar duart ngrihen më lart se në tekbiret e tjera?” Ai tha: “Jo.”¹

Imam Buhariu ka thënë: “Nëse do të vërtetohet hadithi nga Muxhahidi² (që e transmeton Ebu Bekër Ajashi), se ai nuk e ka parë Ibn Omerin duke i ngritur duart e tij, do të ishte hadithi i Tavusit Salimit, Nafiut, Muharib ibn Ditharit dhe Ibn Zubejrit, më i saktë, se ata e kanë parë (duke i ngritur duart) dhe se Ibn Omeri këtë e transmeton nga Pejgamberi ﷺ, e ai nuk do të vepronte në kundërshtim me atë që ka vepruar Pejgamberi ﷺ, dhe

¹ Zinxhiri i transmetimit është i saktë.

² Kemi treguar se hadithi nga Muxhahidi nuk vërtetohet.

ajo që është transmetuar nga dijetarët e Mekës, Medinës, Jemenit, Irakut se ai i ka ngritur duart e tij.

Hadithi 25

Vërtet më ka treguar Musededi, i cili ka thënë: “Na ka treguar Jezid ibn Zureja nga Shube, e ky nga Katadja, e ky nga Haseni (el Basriu), i cili ka thënë: **“Shokët e Pejgamberi ﷺ, kur shkonin në ruku dhe i ngrinin kokat nga rukuja, duart e tyre fluturonin sikurse të ishin freskore.”**¹

¹ Hadithi është i saktë.

Vërejtja e parë: Në dorëshkrimin e saktë përmendet Shube, ndërsa në versionet e tjera përmendet Seid (ibn Ebu Rebahu), që nuk është i saktë.

Vërejtja e dytë: Ky transmetimi është i saktë me dëshmitë e tjera.

Vërejtja e tretë: Transmetimi nga Shube nga Katadja është çdoherë sahih, kështu që refuzohet ajo se Katadja ka bërë tedlis (manipulim në transmetim).

Vërejtja e katërt: Transmetimi që është tek Ebu Davudi, në vëllimin 1, numër 110, në cilin gjenden fjalët: “Deri te gjoksi”, është daif - i dobët, për shkak të tedlisit të Sherik el Kufit.

Hadithi 26

Na ka treguar Musa ibn Ismaili, na ka treguar Ebu Hilali nga Humejd ibn Hilali, i cili ka thënë: **“Kur shokët e Pejgamberit ﷺ faleshin, duart e tyre ishin të ngritura deri te veshët e tyre, sikurse të ishin freskore.”**¹

Imam Buhariu ka thënë: “Prandaj, Haseni (el Basriu) dhe Muhamed ibn Hilali nuk përjashtuan asnjërin nga shokët e Pejgamberit ﷺ.”²

¹ Ky transmetim është hasen - i mirë.

Ebu Hilal Muhamed ibn Salim el Basri është i dobët. Shiko: “Tuhfetu-l-Akvije”, umre 98,17, mirëpo për shkak të dëshmisë së mëparshme transmetimi konsiderohet hasen - i mirë.

² Ky është tekst i qartë që tregon dobësinë e asaj që është transmetuar nga Abdullah ibn Mesudi dhe el Bera për mosngritjen e duarve, sepse as këta dy nuk përjashtohen në ngritjen e duarve, as dobësia që gjendet në transmetim, siç do të sqarohet.

Hadithi 27

Na ka treguar Muhamed ibn Mukatili, na ka informuar Abdullahu, na ka informuar Zaide ibn

Kudame, na ka treguar Asim ibn Kulejb el Xhermi, na ka treguar babai im (Kulejbi), se Vail ibn Huxhri ka treguar duke thënë: “Vërtet do të shikoj namazin e Pejgamberit ﷺ.” Atëherë tha: **“Dhe e shikova atë. Ai qëndroi në këmbë, mori tekbinin dhe i ngriti duart. Pastaj, kur deshi të shkojë në ruku, i ngriti duart sikurse herën e parë, pastaj e ngriti kokën e i ngriti duart njashtu si më parë. Pastaj, kur shkova përsëri tek ai në kohën kur ishte ftohtë, shumica e shokëve të tij ishin të veshur me tessa të trasha (për shkak të të ftohtit), kurse duart i ngrinin nën teshat e tyre.”**¹

Imam Buhariu ka thënë: “Vaili nuk përjashtoi asnjërin nga shokët e Pejgamberit ﷺ se ata, kur faleshin me Pejgamberin ﷺ, nuk i ngrinin duart e tyre.

Imam Buhariu ka thënë: “Transmetohet nga Sufjani, e ky nga Asim ibn Kulejbi, e ky nga Abdurrahman ibn el Esvedi, e ky nga Alkame, i cili ka thënë: “Ibn Mesudi ka thënë: **“A dëshironi t’jua**

¹ Zinxhiri i transmetimit është i saktë. Të saktë e kanë vlerësuar: Ibn Huzejme (714, 480), Ibn Hibani (458) dhe Ibn Xharudi (208).

fal namazin e Pejgamberit ﷺ?” Pastaj u fal dhe nuk i ngriti duart e tij, përveçse një herë.”¹

Imam Ahmedi ka thënë: “Nga Jahja ibn Ademi, i cili ka thënë: “Kam parë në librin e Abdullah ibn

Idrisit që transmeton nga Asim ibn Kulejbi, ku nuk është përmendur fraza: “Kështu që ai nuk i ngriti më (duart e tij).”²

Ky transmetim është më i saktë, sepse, sipas dijetarëve, libri është më i saktë se (të mbajturit në mend), për shkak se njeriu mund të thotë diçka e pastaj, kur kthehet te libri, sheh se e vërteta është ashtu siç shkruan në libër.

¹ Ky hadith nga Ibn Mesudi është i dobët, për shkak të tedlisit të Sufjan Theuriut. Për më tepër shiko: “Nurul-ajnejn”.

² Këtë hadith e kanë konsideruar të dobët ekspertët dhe hafidhët e hadithit, si: imam Abdullah ibn Mubareku, Shafiu, Ahmed ibn Hanbeli, Darimiu, Ebu Hatimi, Jahja ibn Ademi, Ebu Davudi, Bezari, Darekutni, Bejhekiu, Ibn Kattani, Ebu Davudi, Ibn Hibani, Ibn Abdulberri, Neveviu, Ibn Xheuziu, Mubarekfuri dhe të tjerët. Shiko: “Ilel el-hadith” (1/96,247), “El-ilel” (1/346), “Nasbu-r-Raje” (1/395), “Et-Temhid” (9/219), “Sunen el-Bejheki” (2/78), El-Mugni (1/575), “El-Mexhmua” (3/403), “Hulasatu-ahkam” (1/354), “El-Meuduat” (1/21), “Et-Telhisul Habir” (1/22,364), Fethul-Bari (2/257), “Tuhfetul-Ahvadhi” (2/21). Sh. p.

Hadithi 28

Na ka treguar el Hasen ibn er Rebia, na ka treguar Ibn Idrisi, nga Asim ibn Kulejbi, e ky nga Abdurrahman ibn el Esvedi, na ka treguar Alkame se Abdullah (ibn Mesudi, Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: **“Pejgamberi ﷺ na mësoi namazin. Ai qëndroi në këmbë, mori tekbirin dhe ngriti duart e tij, pastaj shkoi përsëri në ruku dhe i vendosi shputat e duarve mes kofshëve të tij.”**¹

Kur i erdhi lajmi Sadit për këtë, tha: “Të vërtetën e ka thënë vëllai im. Kështu vepronim në fillim të Islamit, pastaj jemi urdhëruar të veprojmë kështu (të vendosim duart në gjunjë).”

Imam Buhariu ka thënë: “Ky transmetim është i saktë nga Abdullah ibn Mesudi te dijetarët largpamës dhe vigilentë të hadithit.”²

¹ Zinxhiri i transmetimit është i saktë.

Të saktë e kanë konsideruar: Ibn Huzejme 196, Darakutni 1/339, Ibn Xharudi 196. Po ashtu ky hadith ka dëshmi edhe tek imam Muslimi në “Sahih”.

Imam Buhariu ka thënë: “Ky transmetim është i saktë nga Ibn Mesudi”, sepse transmetimi tjetër nga Ibn Mesudi, që e transmeton Sufjan Theuriu është i dobët, për shkak të tedlisit (manipulimit) të tij.

² Ibn Kajimi ka thënë: “Hadithet që tregojnë për ndalimin e ngritjes së duarve para shkuarjes dhe ngritjes nga rukuja që të gjitha janë batile - të kota (të papranuara) nuk vërtetohet asnjë hadith nga i Dërguari i Allahut ﷺ, nuk vërtetohet nga Abdullah ibn Mesudi asnjë hadith!” Shiko: “Menaru el-Munif”

(49), kurse Ibn Tejmije i ka konsideruar të gjitha hadithe të shpikura dhe të rrejshme. Shiko: “Minhaxh es-Sune” (4/115). Sh. p.

Hadithi 29

Na ka treguar Humejdi, na ka treguar Sufjani, e ky nga Jezid ibn Ebu Zijadi në këtë vend, nga Ibn Ebu Lejla, e ky nga el Bera (ibn Azibi) se ka thënë: **“Vërtet Pejgamberi ﷺ, i ngrinte duart kur merrte tekbir.”**¹

Sufjani ka thënë: “Kur është plakur (Jezid ibn Ebu Zijadi), (njerëzit e panjohur) i pëshpëritnin fjalën: “Thumme lem jeud (kështu që ai nuk i ngriti më duart)”, andaj ai thoshte njëjtë: “Thumme lem jeud.”

¹ Transmetimi është i dobët, për shkak të Jezid ibn Ebu Zejdit, i cili është i dobët, mudelis dhe shiit - shiko në librat e transmetuesve. Dijetarët e hadithit janë pajtuar për dobësinë e këtij hadithi dhe Jezidit. Shiko: “Telhis el-Habir”, vëllimi 1, f. 221.

Disa njerëz janë munduar të gjejnë për këtë “mutaba” (transmetues që e mbështetin) Jezidin, mirëpo mbështetësi është Muhamed ibn Ebu Lejla, që është i dobët.

Imam Neveviu thotë: “Sa i përket përgjigjes ndaj atyre që argumentohen me hadithin e el Berait (Allahu qoftë i kënaqur me të!), është si vijon: E para: është përgjigjja e dijetarëve dhe hafidhëve të hadithit, se hadithi është daif sipas mendimit unanim të tyre. Nga ata që kanë deklaruar për dobësinë e hadithit janë: Sufjan ibn Ujejne, Shafiu, Abdullah ibn Zubejr el Humejdi – mësuesi i Buhariut, Ahmed ibn Hanbeli, Jahja ibn Meini, Ebu Seid Uthaman ibn Seid ed Darimi, Buhariu dhe të tjerët nga pararendësit. Këta janë shtyllat e hadithit dhe imamët e Islamit (në këtë shkencë...). “El-mexhmua”, 3/258. Sh. p.

Dhe kështu hafidhët që kanë dëgjuar (transmetuar) nga Jezid ibn Ebu Zijadi, shumë më herët, si: Theuriu, Shube dhe Zuhejri, nuk i transmetojnë fjalët: “Thuume lem jeud” (kështu që ai nuk i ngriti më duart).

Hadithi 30

Na ka treguar Muhamed ibn Jusufi, na ka treguar Sufjani nga Jezid ibn Ebu Zijadi, e ky nga Ibn Ebu Lejla, e ky nga el Berai (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se ka thënë: **“Pejgamberi ﷺ i ngrinte duart deri afër veshëve kur merrte tekbir.”**¹

Imam Buhariu ka thënë: “Vekiu transmeton nga Ibn Ebu Lejla, e ky nga vëllai i tij – Isai dhe nga el Hakem el Utejbe, nga Ibn Ebu Lejla, e ky nga el Berai se ka thënë: **“E kam parë Pejgamberin ﷺ duke i ngritur duart kur merrte tekbirin, e pas kësaj ai nuk i ngrinte më.”**²

Imam Buhariu ka thënë: “Ibn Ebu Lejla e ka transmetuar këtë hadith naa memoria e tij, kurse ai që transmeton nga libri i Ibn Ebu Lejlës, ai e ka transmetuar nga Ibn Ebu Lejla, nga Jezidi (që

¹ Transmetimi është i dobët.

² Ky transmetim është i dobët për shkak të Muhamed ibn Abdurrahman ibn Ebu Lejlës. Enver Shah Kashmir hanefiu ka thënë: “Ai është i dobët tek unë, ky është përfundimi i shumicës së dijetarëve.” (“Fejdul Bari”, vëllimi 1, f. 168).

Imam Neveviu ka thënë: “Bejhekiu ka thënë: “Ky hadith është transmetuar nga Muhamed ibn Abdurrahman ibn Ebu Lejla, e ai nga vëllai i tij - Isai, nga Abdurrahman ibn Ebu Lejla, nga el Berai se ka thënë: “Thume lem jedud - pas këtij (tekbirit fillestar) ai nuk i ngrinte”. Muhamed ibn Abdurrahman ibn Ebu Lejla nuk argumentohet me hadithet e tij. Sipas dijetarëve dhe ekspertëve të hadithit ai është më i keq (më i dobët) se Jezid ibn Ebu Zijadi.” “El-Mexhmua”, 3/258. Sh. p.

është i dobët), kështu që hadithi kthehet në atë se Jezidi e ka pranuar hadithin “telkin” (duke ia pëshpëritur), kurse e sakta është ajo që kanë transmetuar shumë më herët Theuriu, Ibn Ujejne dhe Shube.

Imam Buhariu ka thënë: “Sa u përket disave që nuk posedojnë dituri, argumentohen me hadithin që e transmeton Vekiu nga el Ameshi, e ky nga el Musejib ibn Rafia, e ky nga Temim ibn Tarefe, e ky nga Xhabir ibn Semure, i cili ka thënë: **“Pejgamberi ﷺ hyri te ne, ndërsa ne ishim duke i ngritur duart në namaz, e ai na tha: “Çfarë është kjo që jam duke parë duke i ngritur duart tuaja sikur të ishin bishta kuajsh të shqetësuar? Prandaj, qetësohuni në namaz!”**”¹

Imam Buhariu ka thënë: “Ky transmetim flet për atë që ka ndodhur në teshehud (ulje) e jo në kijam (qëndrim). Disa njerëz përhëndetnin njëri-tjetrin me selam, prandaj Pejgamberi ﷺ i ndaloi të ngrinin duart në teshehud. Me këtë nuk argumentohet edhe ai që ka pak dije, kjo është një çështje e ditur te dijetarët që nuk ka mospajtime për të. E, nëse themi se ajo që thoni është e saktë, se duart ngrihen vetëm në tekbirin fillestar, do të ishte e ndaluar ngritja e duarve edhe në tekbiret e namazit të Bajramit, për

¹ Hadithi nga Xhabir ibn Sebure është i saktë.

Këte e shënon imam Muslimi. Në këtë hadith ka një tregues fjala arabe “ve hum ku’udun (dhe ata ishin ulur)” në hadithin që e përcjell Temim ibn Tarefe (Musned i Ahmedit vëllimi 5, f. 93). Për më shumë detaje shiko: “Nurul-ajnejn”, f. 92-95.

NGRITJA E DUARVE (PARA DHE PAS RUKUSË) NË NAMAZ

shkak se ky hadith nuk përjashton se në cilin rast ngrihen dhe në cilin nuk ngrihen. Kjo do të sqarohet në hadithin e radhës.

Hadithi 31

Na ka treguar Ebu Nuajmi, na ka treguar Misari, nga Ubejdullah ibn el Kibtu, i cili ka thënë: “Kam dëgjuar Xhabir ibn Semuren duke thënë: “Kur faleshim pas Pejgamberit ﷺ, thoshim: “Es-selamu alejkum! Es-selamu alejkum” - duke treguar Misari me dorën e tij, e në atë rast Pejgamberi ﷺ i tha: **“Ç’është puna e këtyre njerëzve që lëvizin me duart e tyre sikurse të jenë bishta kuajsh të shqetësuar? Mjafton që t’i vendosni duart në kofshë, pastaj të përshëndesni vëllezërit tuaj me selam në anën e djathtë dhe ata që janë në anën e majtë.”**¹”²

Imam Buhariu ka thënë: “Le të bëjnë kujdes dhe le të ruhen ata që i interpretojnë ose flasin për të Dërguarin e Allahut ﷺ, për atë që nuk e ka thënë. Allahu i Madhëruar thotë: **“Le të frikësohen ata që e kundërshtojnë urdhrin e tij, që të mos i arrijë ndonjë sprovë ose që të mos i godasë një dënim i dhembshëm!”** (En Nur, 63)

¹ Hadithi është i saktë.

² Imam Ibn Huzejme në librin e tij “Sahih” në bazë të këtij hadithi e ka titulluar kapitullin 238: “Kapitulli: Qortimi për atë që lëviz me duar djathtas e majtas kur jep selam në namaz.” (1/383) Sh. p.

Hadithi 32

Na ka treguar Muhamed ibn Jusufi, na ka treguar Sufjan ibn Abdulmeliku, i cili ka thënë: “E kam pyetur Seid ibn Xhubejrin për ngritjen e duarve në namaz, e ai më tha: **“Ajo është diçka që e zbukuron namazin tënd.”**¹²

¹ Rebia e ka pyetur imam Shafiun për domethënien e ngritjes së duarve. Ai tha: “Kjo është madhërim për Allahun dhe pasim i Sunetit të Pejgamberit ﷺ.” Në një vend tjetër imam Shafiun thotë: “Nuk lejohet braktisja e ngritjes së duarve.” Muzeniu ka thënë: “E kam dëgjuar Shafiun duke thënë: “Nuk i lejohet askujt që ka dëgjuar hadithin e të Dërguarit të Allahut ﷺ për ngritjen e duarve në hapjen e namazit dhe gjatë përkuljes e ngritjes nga rukuja, që ta braktisë.”

Ibn Adulberri ka transmetuar nga Ibn Omeri se ka thënë: “Ngritja e duarve është stoli dhe zbukurim i namazit.”

Përcillet se Ukbe ibn Amiri (radijallahu anhu) ka thënë: “Për çdo ngritje të duarve ka dhjetë sevape e për çdo gisht një sevap.”

Ibn Sirini ka thënë: “Ajo e kompletton dhe e përmbush namazin.”

Halid el Hadhai e ka pyetur Ebu Kilaben: “Çfarë do thotë kjo: ngritja e duarve në namaz?” Tha: “Madhërim.” (“El-Hilje”, 2/281); (“Fethu-l-Bari”, 2/623), (“Mesailu Salih”, 1244). (“Tabakat Ibn Subki”, 2/100). Sh. p.

² Hadithi është i saktë.

E shënon imam Bejhekiu në librin e tij “Sunen el-Kubra” (2/75) me zinxhir të saktë, nga Seid ibn Xhubejri, se sahabët e nderuar i ngrinin duart e tyre para dhe pas rukusë. Gjithashtu imam Neveviu e ka vlerësuar hadithin të saktë. Shiko: “Mexhua sherh el-Medhahib”, 3/405. Transmetuesi të Bejhekiu “Ja’kub ibn Jusuf el-Ahrem” është imam i shquar dhe i besueshëm. Shiko: “Sunen el-Kubra”, vëllimi 5, f. 230, dhe “Nurul-ajnein”, f. 126. Pohimi i disa hanefinjve bashkëkohorë se Jakubi nuk është i besueshëm është i papranuar dhe i refuzuar.

Hadithi 33

Na ka lajmëruar Mahmudi, na ka lajmëruar Abdurrezaku, na ka lajmëruar Nafiu: **“Ibn Omeri, kur e hapte namazin, merrte tekbirin dhe i ngrinte duart, edhe kur përkulej në ruku, edhe kur thoshte: “Semiallahu limen hamideh”, edhe kur e ngrinte kokën e tij nga rukuja, edhe kur ngrihej në këmbë (pas rekatit të dytë).”**¹

E kam pyetur Nafiun: “A i ka ngritur duart Ibn Omeri në tekbirin fillestar më shumë se në tekbiret e tjera e ai më tha: “Jo.”

Imam Buhariu ka thënë: “Nuk është vërtetuar nga asnjë ekspert i hadithit nga ata që i kemi arritur, si nga Hixhazi, ashtu dhe nga Iraku, e ndër ta janë: Abdullah ibn Zubejri, Ali ibn Abdullah ibn Xhaferi (el Medini), Jahja ibn Meini, Ahmed ibn Hanbeli,² Ishak ibn Rahuje, të cilët ishin dijetarët më të mëdhenj të kohës së tyre,

¹ Zinxhiri i transmetimit është i saktë.

Vërejtja e parë: Këtë transmetim po ashtu e ka shënuar Abadurrezaku në “Musned” (2520).

Vërejtja e dytë: Mahmud ibn Gajlani është imam jashtëzakonisht i besueshëm. Thënia që thotë se ai është i panjohur është e pasaktë. Shiko: “Tehdhib et-Tehdhib”, dhe librat e tjerë.

² Një njeri i tha imam Ahmedit: “Disa njerëz na urdhërojnë për ngritjen e duarve në namaz e disa na ndalojnë?” Imam Ahmedi iu përgjigj: “Atë nuk e ndalon vetëm se bidatçiu. Pejgamberi ﷺ i ka ngritur duart në namaz, e Ibn Omeri e gjuante me guralecë atë që nuk i ngrinte duart.” “Fethul-Bari li Ibn Rexheb”, 6/332. Sh. p.

NGRITJA E DUARVE (PARA DHE PAS RUKUSË) NË NAMAZ

nuk është vërtetuar nga asnjëri prej tyre, nga ajo që dimë, për lënien (braktisjen) e ngritjes së duarve, as nga Pejgamberi ﷺ e as nga shokët e Pejgamberit ﷺ, se ata nuk i kanë ngritur duart e tyre.

Hadithi 34

Na ka treguar Muhamed ibn Mukatili, na ka treguar Abdullahu, na ka treguar Hishami nga el Haseni (el Basri) dhe Ibn Sirini, se ata dy kanë thënë: **“Kur dikush nga ju merr tekbir për namaz, le t’i ngrejë duart e tij kur të marrë tekbirin dhe kur të ngrejë kokën nga rukuja.”**¹

Ibn Sirini e kishte zakon të thoshte: “Kjo (ngritja e duarve) është nga plotësimi i namazit.”

¹ Zinxhiri i transmetimit është i dobët.

Hisham ibn Hasani është mudelis dhe përcjell hadithe me “an” (nga).

Vërejtja e parë: Abdullahu në këtë transmetim është Abdullah ibn Mubareku, kështu që është e pasaktë thënia e disa gënjeshtarëve se Abdullahu këtu është për qëllim Abdullah ibn Lehia.

Vërejtja e dytë: Hisham ibn Hasani është ndër nxënësit e njohur të imam Hasen el Basriut. Shiko: “Tehdhib et-Tehdhib” dhe librat e tjerë.

Hisham ibn Hasan el Ezdi Ebu Abdullah el Basri është transmetues i besueshëm dhe është nga transmetuesit më të besueshëm të Ibn Sirinit. E, sa i përket transmetimit nga Hasen el Basriu dhe Atai është folur për të, për shkak se kanë thënë se ka transmetuar me “an” (me shkëputje), siç ka përmendur Ibn Haxheri në “Et-Takrib” (7289). Kjo nuk dëmton, për shkak se është vërtetuar në rrugë tjetër të transmetimit nga Hasen el Basriu. Shiko verifikimin e librin të Buhariut, f. 98. Sh. p.

Hadithi 35

Na ka treguar Ebu Jemani, na ka informuar Shuajbi nga Zuhriu, e ky nga Salim ibn Abdullahu, se Abdullah ibn Omeri ka thënë: **“E kam parë Pejgamberi (sal-lallahu alejhi ve sele) se, kur merrte tekbirin fillestar për namaz, i ngrinte duart lart deri te supet e tij, e vepronte njëjtë edhe kur merrte tekbir për në ruku dhe kur thoshte “Semiallahu limen hamideh” vepronte njëjtë dhe thoshte: “Rabbena ve lekel hamd.” E, kur shkante në sexhde, nuk i ngrinte duart e as kur e ngrinte kokën nga sexhdeja.”**¹

Imam Buhariu ka thënë: “Ibn Mubareku i ngrinte duart e tij. Sa e dimë ai ishte dijetari më i madh i kohës së tij,² kështu që ai që nuk ka njohuri për diturinë e selefit dhe do ta pasoj (me argument) Ibn Mubarekun në atë që ai ndjek Pejgamberin ﷺ, shokët e tij dhe tabiinët. Kjo do të ishte më mirë për të sesa të argumentohet me

¹ Hadithi është sahih.

Ky transmetim gjendet në “Sahihun” e Buhariut, 738, dhe në vende të tjera.

Është vërtetuar se Zuhriu ka dëgjuar nga Salimi. Shiko në këtë libër hadithin 38.

² Abdulkadir el Kureshi ka përmendur në librin e tij “El-Xhevahir el-Mudije fi tabakat el-Hanefije” (1/280), se shokët e Ibn Mubarekut kanë thënë: “Hajde t’i numërojmë cilësitë e mira të Ibn Mubarekut.” Ata thanë: “Ai ka mbledhur diturinë, fikhun, moralin, gramatikën, gjuhën, asketizmin, poezinë, elokuencën, devotshmërinë, drejtësinë, namazin e natës, ashpërsinë në mendim, të folurit pak për gjëra që nuk i interesojnë, shumë pak ka pasur mosmarrëveshje me shokët e tij.” Sh. p.

fjalën e injorantëve që nuk dinë. Është për t'u habitur kur dikush prej tyre thotë se Ibn Omeri ka qenë në moshë të re në kohën e Pejgamberit ﷺ. Tashmë Pejgamberi ﷺ ka dëshmuar mirësi për të.

Hadithi 36

Na ka treguar Jahja ibn Sulejmani, na ka treguar Ibn Vehbiu, nga Junusi, nga Ibn Shihabi, nga Salim ibn Abdullahu, nga babai i tij (Abdullah ibn Omeri), nga Hafsa se Pejgamberi ﷺ ka thënë: **“Me të vërtetë Abdullah ibn Omeri është njeri i mirë!”**¹

¹ Hadithi është sahih.

Po ashtu këtë hadith imam Buhariu e shënon në “Sahih”, 3740.

Hadithi 37

Na ka treguar Alij ibn Abdullahu, na ka treguar Sufjani i cili ka thënë: “Amri (ibn Dinari) ka thënë:

“Ibn Omeri ka thënë: **“Më kujtohet Omeri kur e pranoi Islamin e njerëzit filluan të thonë: “Dezertoi Omeri! Dezertoi Omeri!” Atëherë erdhi As ibn Vaili e tha: “Dezertoi Omeri!**

Dezertoi Omeri! Dezertoi Omeri!” Edhe çfarë pastaj? Unë jam komshiu i tij (dhe ndihmuesi i tij).” Atëherë e lanë rehat (Omerin).”¹

Seid ibn el Musejibi ka thënë: “Nëse do të dëshmoja për dikë se është prej banorëve të Xhenetit, do të dëshmoja për Ibn Omerin. Allahu qoftë i kënaqur me të!”

Xhabir ibn Abdullahu ka thënë: “Askush nuk i është përmbajtur më shumë sunetit e nuk ka ndjekur Pejgamberin ﷺ më shumë se Ibn Omeri. Allahu qoftë i kënaqur me të!”

Imam Buhariu ka thënë: “(Nuk merret parasysh) kritika e disa injorantëve për Vail ibn Huxhrin.

Vërtet Vail ibn Huxhri është një nga nipat e mbretit të Jemenit dhe, kur erdhi te Pejgamberi ﷺ, ai e nderoi atë e i dha një copë

¹ Këtë hadith imam Buhariu po ashtu e shënon në “Sahih”, 3865 me të njëjtin zinxhir.

NGRITJA E DUARVE (PARA DHE PAS RUKUSË) NË NAMAZ

tokë dhe me të e dërgoi Muavi ibn Ebu Sufjanin. Allahu qoftë i kënaqur me të!

Hadithi 38

Na ka informuar Hafs ibn Omeri, na ka treguar Xhami ibn Matari, nga Alkame ibn Vaili, nga babai i tij (Vail ibn Huxhri): **“Pejgamberi ﷺ ia ndau dhe i dha një copë tokë në Hadramaut.”**¹

Imam Buhariu ka thënë: “Tregimi i Vail ibn Huxhrit është i njohur te dijetarët dhe ajo çfarë ka thënë Pejgamberi ﷺ për të dhe ajo që i ka dhuruar. Të gjitha këto janë të njohura. Edhe ajo se ai shpesh e ka vizituar Pejgamberin ﷺ. Edhe sikur të jetë e vërtetë ajo që transmetohet nga Ibn Mesudi, el Berai dhe Xhabiri, se Pejgamberi ﷺ ka vepruar ashtu dhe ashtu, injorantët për të do të kishin thënë:

“Nëse diçka e tillë do të ishte vërtetuar nga Pejgamberi ﷺ dhe të parët tanë se nuk kanë vepruar ashtu, kjo nuk do të pranohet!” Kështu, këta njerëz i marrin vetëm hadithet që përputhen me mendimet e tyre.

(Imam) Vekiu ka thënë: “Kushdo që mundohet ta mësojë hadithin ashtu siç ka ardhur, ai është pasues i Sunetit, e, kush e mëson hadithin më qëllim që të përputhet me epshin e tij, ai është bidatçi!

¹ Zinxhiri i transmetimit është sahih. Imam Tirmidhiu, 1381 e ka vlerësuar hadith hasen.

Domethënë, njeriu duhet të hedhë poshtë dhe ta braktisë mendimin e vet kur t'i vërtetohet saktësia e hadithit nga Pejgamberi ﷺ dhe hadithi nuk mund të hidhet poshtë me shpjegime të kota e të pasakta vetëm për të mbështetur në pasionin dhe epshin e vet.

Përmendet se Pejgamberi ﷺ ka thënë: **“Nuk ka besuar asnjëri prej jush përderisa pasionet e tij të pasojnë atë me të cilën kam ardhur.”**¹

Dhe, Mameri (ibn Rashidi) ka thënë: “Dijetarët muslimanë kanë thënë se të parët që kanë ndërruar jetë kanë qenë më të ditur se të tjerët, ndërsa sipas tyre (mohuesve) këta të kohës së sotme janë më të ditur se paraardhësit (selefët)!

Abdullah ibn Mubareku thotë: “Jam falur përballë Numan ibn Thabitit (Ebu Hanifes) dhe i ngrita duart, ndërsa ai më tha: “U frikova se mos po fluturon!” Atëherë i thashë: “Kur ti nuk fluturova në fillim (të ngritjes së duarve), atëherë as unë nuk fluturoj në të dytin (te rukuja)!”²

¹ Ky transmetim është i dobët për shkak të tedlisit nga Hisham ibn Hishami, kështu që për shkak të panjohurisë (xhehale) hadithi konsiderohet i dobët, mirëpo argumentet nga Kurani dhe Suneti në përgjithësi tregojnë dhe e mbështesin këtë.

² Transmetimi i dialogut që ndodhi mes Ibn Mubarekut dhe Ebu Hanifes gjendet në librat e mëposhtëm me zinxhir transmetimi sahih: “Tevilu muhtelifi hadith” nga Ibn Kutejbe, 66, “Es-Sunne” nga Abdullah ibn Ahmed ibn Hanbeli, 518, “Tarih Bagdad”, vëllimi 3, f. 405-406, “El-Muntadhim” nga Ibn Xheuzi,

Vekiu ka thënë: “Allahu e mëshiroftë Ibn Mubarekun: e kishte përgjigjen të gatshme, kurse i dyti (Ebu Hanifja) u hutua dhe nuk i ktheu përgjigje.”

Kështu ndodh me ata të cilët këmbëngulin në gabimet e tyre dhe nuk mendojnë.

vëllimi 8, f. 136, “Es-Sunne el-Kubra” nga Bejhekiu, vëllimi 2, f. 82. Shiko: “Kitab el-Esanid es-Sahiha fi ahbar Ebi Hanife”, 29-36.

Hadithi 39

Na ka treguar Abdullah ibn Salihu, më ka treguar Lejthiu, më ka treguar Junusi, e ky nga Ibn Shihabi, më ka treguar Salim ibn Abdullahu, se Abdullah Ibn Omeri ka thënë: **“E kam parë Pejgamberin ﷺ se, kur ngrihej për namaz, i ngrinte duart deri te supet, pastaj merrte tekbir. Ashtu vepronte edhe kur e ngrinte kokën nga rukuja dhe thoshte: “Semiallahu limen hamideh”, e, kur e ngrinte kokën nga sexhdeja, nuk i ngrinte duart.”**¹

¹ Hadithi është i saktë.

Junus ibn Jezid el Aili është i besueshëm sipas shumicës së dijetarëve të hadithit dhe hadithet e tij janë sahih. Kritika që i është bërë për të është e papranuar. Shiko: “Tehdhibu et-Tehdhib” dhe librat e tjerë.

Hadithi 40

Na ka treguar Ebu en Numani, na ka treguar Abdulvahid ibn Zijad esh Shejbani, na ka treguar Muharib ibn Dithari, i cili ka thënë: **“E pashë Abdullah ibn Omerin kur e hapte namazin, merrte tekbir dhe i ngrinte duart e tij, edhe kur dëshironte të shkonte në ruku i ngrinte duart, e edhe kur e ngrinte kokën nga rukuja.”**¹

¹ Zinxhiri i transmetimit është sahih.

Ebu Numanit - Muhamed ibn Fadele Arimit i është dobësuar memoria në vitet e fundit, mirëpo ai nuk ka transmetuar asgjë në atë kohë. Shiko: “Tehdhib et-Tehdhib”, “El-Keshf” nga Dhehebiu, vëllimi 3, f. 79, 1597, dhe “Nurul Ainein”, f. 88. Kështu, të gjitha transmetimet nga Ebu Numani janë sahih. Hafidh Dhehebiu ka thënë: “Në vitet e fundit, kur iu dobësua kujtesa, ai nuk transmetoi asgjë.” Duhet ditur se imam Buhariu transmeton hadithe nga Ebu Numani shumë më herët se t’i dobësohej kujtesa. Falënderimi i takon Allahut.

Hadithi 41

Na ka treguar el Ajash ibn el Velidi, na ka treguar Abdulala, na ka treguar Ubejdullahu, e ky nga

Nafiu, e ky nga Ibn Omeri: **“Ai mori tekbirin dhe i ngriti duart. Edhe kur ra në ruku i ngriti duart, e edhe kur tha: “Semiallahu limen hamideh” i ngriti duart. Ibn Omeri thoshte se kështu ka vepruar edhe Pejgamberi ﷺ.”**¹

¹ Hadithi është sahih. Gjithashtu e shënon Buhariu në “Sahih”, 739.

Vërejtje: Kundërshtimi i këtij transmetimi nga imam Ebu Davudi është i pranuar. Këtë transmetim e ka vërtetuar imam Buhariu, Begaviu, Ibn Huzejme, Ibn Tejmije dhe shumica e dijetarëve të hadithit. Shiko: “Nurul el-Ainein”, f. 64.

Hadithi 42

Na ka treguar Ibrahim ibn el Mundhiri, na ka treguar Mameri, na ka treguar Ibrahim ibn Tahmani nga Ibn Zubejri, i cili ka thënë: **“E pashë Ibn Omerin kur u ngrit për në namaz duke i ngritur duart deri afër veshëve. Ashtu vepronte edhe kur e ngrinte kokën nga rukuja, edhe kur qëndronte drejt.”**¹

¹ Zinxhiri i transmetimit është Hasen.

Për këtë dëshmon transmetimit që gjendet në librin “Mesail Abdullah ibn Hanbel”, 243, 244, dhe në “Et Temhid”, 9/217.

Hadithi 43

Na ka treguar Abdullah ibn Salihu, na ka treguar el Lejthiu, më ka treguar Nafiu: **“Kur Abdullahu (ibn Omeri) qëndroi për të falur namazin, i ngriti duart e tij, edhe kur shkoi në ruku, edhe kur e ngriti kokën nga rukuja, edhe kur u ngrit pas rekatit të dytë, merrte tekbir dhe i ngrinte duart e tij.”**¹

¹ Sahih.

Kur ekspertët e dijetarëve të hadithit, bie fjala, Buhariu, transmetojnë nga Abdullah ibn Salihu, atëherë ky hadith është sahih. Shiko: “Tedhib et-Tehdhib”, “Hadiu es-Sarim Mukadimetu Feht el-Bari”, dhe të tjerë, kështu që mospranimi i këtij transmetimi, vetëm pse transmetuesi është i njohur si “ai që shumë gabon në transmetimin e hadithit” është i papranuar. Përveç kësaj, ky transmetim ka shumë zinxhirë të transmetimit.

Hadithi 44

Na ka treguar Musa ibn Ismaili, na ka treguar Hamad ibn Seleme, e ky nga Ejubi, e ky nga Nafiu, e ky nga Ibn Omeri: **“I Dërguari i Allahut ﷺ, kur merrte tekbir, i ngrinte duart, edhe kur shkonte në ruku, edhe kur e ngrinte kokën nga rukuja i ngrinte duart.”**¹

¹ Sahih.

E shënon imam Bejhekiu nga Musa ibn Ismaili në “Marifetu-s-Sunen vel Ether” (1/42).

Vërejtje: Ky transmetim është përcjellë para se Hamad ibn Seleme filloi të ngatërrojë hadithet. Shiko: “El Kevakibu Niran”, dhe të tjerët. Por, megjithatë ky hadith ka dëshmi të shumta. Imam Muslimi këtë e shënon në zinxhir përmes Katades, 391, 865.

Hadithi 45

Na ka treguar Musa ibn Ismaili, na ka treguar Hamad ibn Seleme, na ka informuar Katadja, e ky nga Nasr ibn Asimi, e ky nga Malik ibn Huvejrithi: **“Pejgamberi ﷺ, kur hynte në namaz, i ngrinte duart deri te lapat e veshëve, e ashtu vepronte edhe kur shkonte në ruku dhe kur e ngrinte kokën nga rukuja.”**¹

¹ Sahih. Ibrahim ibn Tahmani ka thënë: “Atij që nuk i ngre duart, thoni: “Herën e parë nga ku i ngre duart?” Shiko: “Sahih Ibn Hiban”, me referencë në “Ithafu el-Mahara Ibn Haxher”, 13/89.

Hadithi 46

Na ka treguar Mahmudi, i cili ka thënë: “Ibn Uleje ka thënë se Halidi i ka thënë: **“Vërtet Ebu Kilabe i ngrinte duart e tij kur shkonte në ruku dhe kur e ngrinte kokën nga rukuja, ndërsa kur shkonte në sexhde, së pari i vendoste gjunjët, e, kur ngrihej, mbështetej me duart e tij dhe tha: “Në rekatin e parë pushonte pak, pastaj çohet.”**”¹

Imam Buhariu ka thënë: “Këtë ai e përmendi nga Malik ibn Huvejrithi.”²

¹ Daif.

Vërejtje: Nëse këtu me Mahmudin është për qëllim “Mahmud ibn Gajlan”, atëherë zinxhiri i transmetimit është sahih, e nëse mendohet për “Mahmmud ibn Ishak el Huzain, atëherë zinxhiri i transmetimit është i shkëputur. Për shkak të pasugurisë e kam vleruar si të dobët, ndërsa Allahu e di më së miri.

² Këtë e trasmeton Hatib el Bagdadi me zinxhir nga Muhamed ibn Ishak Ibn Huzejme duke thënë: “Na ka treguar Ebu Bishr el Vasiti, na ka treguar Halidi nga Ebu Kilabe se ai e ka parë Malik ibn Huvejrithin se, kur falej, merrte tekbir dhe i ngrinte duart dhe kur shkonte në ruku i ngrinte duart dhe kur e ngrinte kokën nga rukuja ai i ngrinte duart dhe thoshte se i Dërguari i Allahut (ﷺ) kështu është falur. Shiko: “Sahih Ibn Huzejme”, (585). Sh. p.

Hadithi 47

Na ka informuar Abdullah ibn Muhamedi, na ka informuar Ebu Amiri, na ka treguar Ibrahim ibn

Tahmani, nga Ebu Zebejri, nga Tavusi: **“Ibn Abasi, kur qëndronte për të falur namazin, i ngrinte duart deri te veshët, e ashtu vepronte edhe kur e ngrinte kokën nga rukuja dhe kur drejtohej në këmbë.”**¹

¹ Sahih.

Zinxhiri i transmetimit është i dobët për shkak të tedlisit të Ebu Zubejrit, mirëpo ky hadith ka dëshmi të tjera, kështu që bëhet sahih.

Hadithi 48

Na ka treguar Muhamed ibn Mukatili, na ka informuar Abdullahu, na ka informuar Ismaili, më ka treguar Salih ibn Kejsani, e ky nga Abdurrahman el Arexhi, e ky nga Ebu Hurejra, i cili ka thënë:

“Pejgamberi ﷺ i ngrinte duart deri te supet kur merrte tekbir për hapjen e namazit, e edhe kur shkonte në ruku.”¹

¹ Ky hadith është sahih me këtë tekst.

Për shkak të Ismail ibn Ajashit që e transmeton këtë hadith ky hadith që nuk është nga Shami, ky zinxhir është i dobët (për shkak se transmetimet e tij nga ata që nuk janë nga Shami konsiderohen të dobëta), mirëpo teksti i hadithit është sahih për shkak të dëshmimeve të tjera. Shiko: “Sahih Ibn Huzejme”, (1/344).

Vërejtje: Në dorëshkrimin tjetër të Indisë pas emrit Muhamed ibn Mukatili qëndron “Na ka treguar Afiu”, që është një gabim, mirëpo fjalët e sakta janë: “Na ka treguar Abdullahu”, siç qëndron në dorëshkrimin real dhahirij.

Hadithi 49

Na ka treguar Ismaili, na ka treguar Maliku nga Nafiu: “**Kur Abdullah ibn Omeri e hapte namazin, i ngrinte duart deri te supet e tij, e edhe kur e ngrinte kokën nga rukuja.**”¹

¹ Sahih. Transmetimi gjendet tek Ebu Davudi në “Sunen” me zinxhir nga imam Maliku.

Vërejtje: Në dorëshkrimin e Indisë dhe në disa versione të tjera të këtij libri, pas fjalëve: “Na ka treguar Ismaili”, nuk është regjistruar: “Na ka treguar Maliku”, mirëpo kjo gjendet në versionin e vërtetë, në dorëshkrimin dhahirij.

Hadithi 50

Na ka treguar Muhamed ibn Mukatili, na ka informuar Abdullahu (ibn Mubareku), na ka informuar Ibn Axhlani, i cili ka thënë: “E kam dëgjuar Numan ibn Ebu Ajashin të thotë: **“Çdo gjë e ka stolinë e vet, e stolia e namazit është të ngresh duart kur merr tekbir, kur të shkosh në ruku dhe kur të ngresh kokën nga rukuja.”**¹

¹ Zinxhiri i transmetimit është sahih.

Vërejtja e parë: Në dorëshkrimin e Indisë qëndron e shkruar: “Na ka treguar Abdullah ibn Axhlani”, që është gabim. Në dorëshkrimin dhahirij, pasi që përmendet Muhamed ibn Mukatili, qëndron: “Na ka treguar Abdullahu, na ka treguar Ibn Axhlani”, që është e saktë.

Vërejtja e dytë: Nëse vërtetohet dëgjimi nga Muhamed ibn Axhlani, atëherë hadithi është sahih. Shumica e dijetarëve të hadithit e kanë konsideruar të besueshëm dhe të saktë. Pretendimi se ai i ka gabuar në këtë hadith nuk është i pranuar.

Hadithi 51

Na ka treguar Muhamed ibn Mukatili, na ka informuar Abdullahu (ibn Mubareku), na ka informuar

el Euzai, më ka treguar Hasan ibn Atije, e ky nga el Kasim ibn Muhajmire,¹ i cili ka thënë: **“Ngritja e duarve bëhet kur merr tekbire.” Dhe tha: “Mendoj se edhe kur të shkosh në ruku.”**²

¹ Ai është imami Ebu Urve el Hemadani el Kufi, i zbritur në Damask. Të besueshëm e kanë konsideruar Jahja ibn Meini dhe të tjerët. Ishte dijetar, hafidh dhe mësues në Kufe. Ishte nga ata që kënaqej me pak. (100h) Shiko: “Thikat” nga Ibn Hibani (5/307). Sh. p.

² Zinxhiri i transmetimi është sahih.

Hadithi 52

Na ka treguar Muhamed ibn Mukatili, e ky nga Abdullah (ibn Mubareku), na ka informuar Sherik (ibn Abdullah el Kadi), e ky nga Lejthiu, e ky nga Atai, i cili ka thënë: **“E kam parë Xhabir ibn Abdullahun, Ebu Seid el Hudriun, Ibn Abasin dhe Ibn Zubejrin duke i ngritur duart kur e fillonin namazin, kur binin në ruku dhe kur i ngrinin kokat e tyre nga rukuja.”**¹

¹ Hasen.

Vërejtje: Në dorëshkrimin dhahirij qëndron shkruar: “Na ka treguar Muhamed ibn Mukatili”, ndërsa në dorëshkrimin indian qëndron: “Na ka treguar Mukatili”, gjë që nuk është e saktë.

Hadithi 53

Na ka treguar Muhamed ibn Mukatili, na ka informuar Abdullahu (ibn Mubareku), na ka informuar Ikrime ibn Amari, i cili ka thënë: **“E kam parë Salim ibn Abdullahun, el Kasim ibn Muhamedin, Atain dhe Mekhulin duke i ngritur duart e tyre në namaz kur shkonin në ruku dhe kur ngriheshin (nga rukuja).”**¹

¹ Zinxhiri është hasen.

Nëse Ikrime ibn Amari e vërteton dëgjimin e tij, atëherë ai është hadith hasen.

Hadithi 54

Xheriri ka thënë nga Lejthiu, e ky nga Atai dhe Muxhahidi se ata dy i kanë ngritur duart në namaz, e ashtu vepronin edhe Nafiu dhe Tavusi.¹

¹ Hasen.

Këto ethere nuk gjenden në zinxhirin e transmetimit të tyre, mirëpo ngritja e duarve nga Atai, Muxhahidi, Nafiu dhe Tavusi janë të konfirmuara nga burimet e besueshme.

Hadithi 55

Edhe nga Lejthiu, nga Ibn Omeri, Seid ibn Xhubejri, Tavusi dhe shokët e tij, që të gjithë i ngrinin duart kur binin në ruku.¹

¹ Hasen.

Zinxhiri i transmetimit nuk gjendet, mirëpo për shkak të dëshmime të tjera ky hadith konsiderohet hasen.

Hadithi 56

Na ka treguar Musa ibn Ismaili, na ka treguar Abdulvahid ibn Zijadi, na ka treguar Asimi, i cili ka thënë: **“E kam parë Enes ibn Malikun kur e fillonte namazin, merrte tekbir dhe sa herë që shkonte në ruku e ngrihej nga rukuja, i ngrinte duart.”**¹

¹ Zinxhiri i transmetimit është i saktë.

Hadithi 57

Na ka treguar Halife ibn Hajati, na ka treguar Jezid ibn Zureji, na ka treguar Seidi, e ky nga Katadja, se Nasr ibn Asimi i ka treguar nga Malik ibn Huvejrithi se ka thënë: **“E kam parë Pejgamberin ﷺ duke i ngritur duart kur shkonte në ruku dhe kur e ngrinte kokën nga rukuja. Ai i ngrinte duart deri te lapat e veshëve.”**¹

¹ Sahih.

E shënon imam Muslimi me zinxhir nga Seid ibn Ebu Arube, 26/391.

Hadithi 58

Abdurrahman ibn Mehdiu ka thënë nga Rebi ibn Subejhu se ai ka thënë: **“E kam parë Muhamedin (ibn Sirinin), Hasenin (el Basriun), Ebu Nadren, Kasim ibn Muhamedin, Atain, Tavusin, Muxhahidin, Hasen ibn Muslimin, Nafiun, Ibn Nexhahun se, kur e fillonin namazin, i ngrinin duart, edhe kur shkonin në ruku, edhe kur i ngrinin kokat nga rukuja.”**¹

Imam Buhariu ka thënë: “Këta dijetarë nga Meka, Medina, Jemeni, Iraku, që të gjithë janë pajtuar rreth ngritjes së duarve para dhe pas rukusë.

¹ Hasen.

Ebu Bekër el Ethremi e transmeton këtë me zinxhir të plotë e të pandërprerë, nga Rabia ibn Subejhu. Shiko:

“Temhid” (9/218).

Rebi ibn Subajhu është transmetues i dobët sipas shumicës së dijetarëve të hadithit, kështu që ky zinxhir i transmetimit është i dobët, mirëpo hadithi është hasen për shkak të dëshmive të tjera.

Hadithi 59

Vekiu ka thënë nga Rebia se ka thënë: **“E kam parë Hasenin (el Basriun), Muxhahidin, Atain, Tavusin, Kajs ibn Sadin, el Hasen ibn Muslimin duke i ngritur duart kur binin në ruku edhe kur binin në sexhde.”**¹

Abdurrahman ibn Mehdiu² ka thënë: **“Kjo është prej sunetit!”**

¹ Hadithi është daif.

Ky transmetim nuk është gjetur me zinxhir të pashkëputur, ndërsa nga Kajs ibn Sadi është vërtetuar në transmetime të tjera ngritja e duarve nga dijetarët e tjerë.

² Abdurrahman ibn Mehdiu është një nga imamët dhe hafidhët e mëdhenj të hadithit (135-198 h), njëherazi mësuesi i Ahmed ibn Hanbelit, Jahja ibn Meinit dhe Ali ibn Medinit. Ali ibn Medini ka thënë: “Sikur të betohesha mes Ruknit dhe Mekamit (mes Gurit të Zi dhe Mekamit të Ibrahimit, alejhi selam), do të betohesha në Allahun se nuk kam parë njeri më të ditur në hadith se atë!” Sh. p.

Hadithi 60

Omer ibn Junusi ka thënë: “Na ka treguar Ikrime ibn Amari se ai ka thënë: **“E kam parë el Kasimin, Tavusin, Mekhulin, Abdullah ibn Dinarin, Salimin dhe Nafiun duke i ngritur duart kur e fillonin namazin dhe kur binin në ruku e në sexhde.”**¹

¹ Hasen.

Ky transmetim nuk është gjetur me zinxhir të pashkëputur, mirëpo konsiderohet hasen për shkak të dëshmive të tjera.

Në dorëshkrimin dhahirij përmendet Omer ibn Junusi, ndërsa në dorëshkrimin indian gabimisht qëndron Amër ibn Junusi.

Hadithi 61

Vekiu ka thënë nga el Ameshi, e ky nga Ibrahim (en Nehaiu) se atij iu përmend hadithi që e transmeton Vail ibn Huxhri: **“Pejgamberi ﷺ i ka ngritur duart para se të bjerë në ruku dhe kur ka rënë në sexhde.”**

Ibrahimi për këtë tha: “Mbase këtë e veproi një herë.”¹

Ky është një supozim nga ai, duke u bazuar në fjalët e tij: “Mbase këtë e veproi një herë”, dhe duke e ditur se Vaili vetë e ka përmendur se e ka parë Pejgamberin ﷺ, dhe shokët e tij, shumë herë duke i ngritur duart.

Kështu, Vaili nuk ka nevojë për supozime e dyshime, sepse vrojtimi dhe këndvështrimi i tij (ndaj namazit të tij) është shumë më i madh dhe më parësor se supozimet e të tjerëve.

Imam Buhariu ka thënë: “Zaide (ibn Kudame) e sqaroi këtë kur tha: “Na ka treguar Asimi, na ka treguar babai im (Kulejb el Xhermi), se Vail ibn Huxhri e ka njoftuar duke thënë: **“Do të shikoj namazin e Pejgamberit ﷺ si falet. Ai mori tekbir dhe i**

¹ Ky transmetimi është daif.

E para: Ky transmetimi nuk është gjetur me zinxhir të pashkëputur.

E dyta: el Ameshi është mudelis, ndërsa transmetimi i mudelisit përtej “Dy librave sahih”, që transmetohet me “an” (nga), konsiderohet daif. Shiko: “Hazainu Sunen”, vëllimi 1, f. 1, nga Sarfaraz Safdari dhe librat e tjerë të mustalah hadithit.

ngriti duart, e, kur ra në ruku, i ngriti përsëri duart dhe, kur e ngriti kokën, i ngriti duart njëjtë. Pas njëfarë kohe kur shkova në Medinë, kur ishte ftohtë, i pashë njerëzit të veshur me rroba të trasha e duart i lëviznin nën teshat e tyre.”¹

Ky është Vail ibn Huxhri që e sqaroi hadithin e tij se ai e ka parë Pejgamberin ﷺ dhe shokët e tij duke i ngritur duart e tyre herë pas here.

¹ Sahih.

Koha e ftohë është diçka për të cilën ka arsye për lehtësim e, përkundër kësaj, ata ishin të prirë të praktikonin këtë sunet profetik, mos e shkelnin e të mos e neglizhonin. Sh. p.

Hadithi 62

Na ka treguar Abdullah ibn Muhamedi, na ka treguar Ibn Idrisi, i cili ka thënë: “E kam dëgjuar Asim ibn Kulejbin, e ky nga babai i tij duke thënë: “E kam dëgjuar Vail ibn Huxhrin duke thënë:

“Erdha në Medinë dhe thashë: “Vërtet do të shikoj namazin e Pejgamberit ﷺ.” Kështu, ai e hapi namazin dhe mori tekbirin e i ngriti duart, e, kur e ngriti kokën, (përsëri) i ngriti duart.”¹

¹ Zinxhiri i transmetimit është sahih. Ibn Huzejme e ka vlerësuar të saktë (641).

Hadithi 63

Na ka treguar Ismail ibn Ebu Uvejsi, na ka treguar Maliku, e ky nga Nafiu se: **“Abdullah ibn Omeri, kur e hapte namazin, i ngrinte duart, e edhe kur e ngrinte kokën nga rukuja, i ngrinte duart.”**¹

¹ Sahih.

Hadithi 64

Na ka treguar Ajashi, na ka treguar Abdulelala, na ka treguar Humejdi, e ky nga Enesi se: **“Ai i ngrinte duart e tij kur shkonte në ruku.”**¹

¹ Sahih.

Hadithi 65

Na ka treguar Ademi, na ka treguar Shube, na ka treguar el Hakem ibn Utejbe, i cili ka thënë: **“E kam parë Tavusin duke i ngritur duart e tij kur merrte tekbirin dhe kur e ngrinte kokën nga rukuja.”**¹

Imam Buhariu ka thënë: “Kush pretendon se ngritja e duarve është bidat, ai vërtet ka fyer shokët e Pejgamberit ﷺ, selefët që erdhën pas tyre dhe dijetarët e Hixhazit, Medinës, Mekës dhe shumicën e dijetarëve të Irakut, Shamit, Jemenit dhe dijetarët e Horosanit, njëri prej të cilëve është Ibn Mubareku, saqë edhe dijetarët dhe mësuesit tanë, si: Isa ibn Musain, Ebu Ahmedin, Kab ibn Seidin, el Hasen ibn Xhaferin, Muhamed ibn Selamin, duke përfshirë ehlun e rejin (pasuesit e mendimeve), e edhe Ali ibn

Hasenin, Abdullah ibn Othmanin, Jahja ibn Jahjain, Sadakain, Ishakun (ibn Rahujen) dhe shumicën shokëve të Ibn Mubarekut.

Sufjan eth Theuriu dhe Vekiu, e disa prej Kufes, nuk i ngrinin duart e tyre. Megjithatë, ata kanë transmetuar shumë hadithe për këtë dhe kurrë nuk e kanë qortuar atë që i ngrinte duart (para dhe pas rukuje), sikur të mos jetë kjo hak - e vërtetë (ngritja e duarve), ata nuk do t'i transmetonin ato hadithe, sepse askush nuk do që t'i

¹ Zinxhiri i transmetimit është sahih.

NGRITJA E DUARVE (PARA DHE PAS RUKUSË) NË NAMAZ

atribuojë Pejgamberit ﷺ, atë që ai nuk e ka thënë dhe atë që nuk e ka vepruar, për shkak të fjalës së Pejgamberit ﷺ që ka thënë: **“Kush shpif për mua atë që nuk e kam thënë, le të përgatitë për veten një vend në Zjarr!”**

E, nuk vërtetohet nga asnjëri prej shokëve të Pejgamberit ﷺ se ata nuk i kanë ngritur duart dhe nuk ka zinxhirë më të saktë transmetimi se ata për ngritjen e duarve në namaz!¹

¹ Çdo gjë që është transmetuar nga sahabët për braktisjen e ngritjes së duarve në namaz nuk është e saktë! Këtë e ka përmendur edhe Bejhekiu në “El-Marife”, pastaj ez Zejlai në “Nasb er-Raje” dhe hafidh Ibn Haxheri në “Ed-Diraje” duke e përmendur edhe arsyen. Hafidh Ibn Haxheri thotë: “Nuk ka zinxhir më të saktë sesa zinxhirët e haditheve të ngritjes së duarve. Sh. p.

Hadithi 66

Na ka treguar Muhamed ibn Ebu Bekër el Mukademi, na ka treguar Mutemiri, e ky nga Ubejdullah ibn Omeri, e ky nga Ibn Shihabi, e ky nga Salim ibn Abdullahu, e ky nga babai i tij (Ibn Omeri) se Pejgamberi ﷺ: **“Kur e fillonte namazin, i ngrinte duart e tij, e edhe kur dëshironte të binte në ruku dhe kur e ngrinte kokën. Po ashtu, kur ngrihej nga rekati i dytë, i ngrinte duart. Në të gjitha këto pozicione i ngrinte duart edhe Abdullah ibn Omeri.”**¹

¹ Sahih.

Këtë e transmeton me zinxhir imam Nesaiu, Ibn Huzejme dhe Ibn Hibani, nga Mutemir ibn Sulejmani.

Hadithi 67

Na ka treguar Kutejbe, na ka treguar Hushejmi nga Zuhriu, e ky nga Salimi, e ky nga babai i tij (Abdullah ibn Omeri) se ka thënë: **“I Dërguari i Allahut ﷺ i ngrinte duart kur e fillonte namazin dhe kur binte në ruku i ngrinte duart, e edhe kur e ngrinte kokën nga rukuja.”**¹

¹ Sahih.

Hadithi 68

Na ka treguar Abdullah ibn Salihu, më ka treguar Lejthiu, na ka treguar Akili, nga Ibn Shihabi, i cili ka thënë: “Më ka treguar Salim ibn Abdullahu, se Abdullah ibn Omeri, ka thënë: **“Kur i Dërguari i Allahut ﷺ e fillonte namazin, i ngrinte duart deri te supet, e edhe kur dëshironte të binte në ruku dhe pasi e ngrinte kokën e tij nga rukuja.”**¹

¹ Sahih.

Hadithi 69

Na ka treguar Muhamed ibn Abdullah ibn Haushebi, na ka treguar Abdulvehabi, na ka treguar Ubejdullahu, e ky nga Nafiu, e ky nga Ibn Omeri se ai: **“I ngrinte duart kur hynte në namaz, kur binte në ruku dhe kur thoshte: “Semiallahu limen hamideh.” Po ashtu, kur ngrihej nga rekati i dytë, ai i ngrinte.”**

Dhe, transmetohet nga Zuhriu, e ky nga Salimi, e ky nga Abdullah ibn Omeri nga: **“Pejgamberi ﷺ se ai ka vepruar njëjtë.”**¹

¹ Sahih.

Hadithi 70

Vekiu ka shtuar (në sened), nga el Umeri¹, nga Ibn Omeri: **“Pejgamberi ﷺ i ngrinte duart e tij kur binte në ruku dhe kur binte në sexhde.”**²

Imam Buhariu ka thënë: “Hadithi i ruajtur (i saktë) është ai që transmeton Ubejdullahu nga Ejubi, Maliku, Ibn Xhurejxhi, Lejthiu dhe një grup i madh nga banorët e Hixhazit dhe Irakut, nga Nafiu, nga Ibn Omeri, se duart i ngrinte kur binte në ruku dhe kur e ngrinte kokën nga rukuja.

Nëse do të vërtetohej hadithi i el Umeriut që e transmeton nga Nafiu, e ky nga Ibn Omeri, nuk do të jetë në kundërshtim me hadithin e parë, sepse në të parin kanë thënë: “Kur e ngrinte kokën e tij nga rukuja.” Nëse kjo do të vërtetohej, atëherë do t'i përdornim (punonim me) të dyja transmetimet. Kjo nuk

¹ El Umeri është Abdullah el Mukebir ibn Omer ibn Hafs ibn Asim ibn Omer ibn Hatabi. Është i dobët. Imam Ahmedit për të ka thënë: “Ai shton në senede - zinxhirë të transmetimeve dhe kundërshton.” Shiko:

“Et-Tehdhib” (5/227). Sh. p.

² Daif.

Ky tekst i hadithi nuk mund të gjendet i plotë me zinxhir nga Vekiu. Te “Musnedi imam Ahmedit” ky transmetim shënohet më shkurt. Zinxhiri tek Ahmedit është hasen. Transmetimi nga Umeri nga Nafiu është sahih. Shiko librat që flasin për transmetues “Etheru-Sunen”.

konsiderohet maspajtim, se nuk përputhen transmetuesit në mendime, sepse kjo shtesë (nga transmetuesi që është i besueshëm) është shtesë në vepër, e shtesa nga transmetuesi i besueshëm është e saktë nëse vërtetohet saktësia e saj.

Vekiu ka thënë: “Nga Ibn Ebu Lejla, nga Nafiu, nga Ibn Omeri dhe nga Ibn Ebi Lejla, nga el Hakemi, e ky nga Muksimi, e ky nga Ibn Abasi, e ky nga Pejgamberi ﷺ se ka thënë: **“Duart nuk ngrihen përveçse në shtatë vende: në fillim të namazit, kur kthehesh nga Qabeja, në Safa e Merva, në Arafat, në Muzdelife dhe te hedhja e gurëve në dy vende (xhemretejn).”**¹

Ali ibn Mushiri dhe Muharibi e transmetojnë nga Ibn Ebu Lejla, nga el Hakemi, nga Miksemi, nga Ibn Abasi (radijallahu anhu), nga Pejgamberi ﷺ.

Shube ka thënë: “El Hakemi nuk ka dëgjuar hadithe nga Miksemi, përveç katër haditheve, e ky hadith nuk është prej tyre.”

Ky transmetim nuk është i ruajtur (i saktë) nga Pejgamberi ﷺ, sepse nxënësit e Nafiut e kanë kundërshtuar (Ibn Ebu Lejlën), ndërsa hadithi që e transmeton el Hakemi nga Miksemi është mursel (me zinxhir të ndërprerë).

¹ Daif. Transmetuesi Muhamed ibn Abdurrahman ibn Ebu Lejla te shumica e dijetarëve të hadithit është i dobët. Vërejtje: I njëjti transmetim që transmetohet në “Musanef” tek Ibn Ebu Shejbe është i dobët për shkak të ngatërresave të transmetuesit Ata ibn Saibi. Shiko: “El-kevakibu Niran” nga Ibn Kejali dhe librat e tjerë në përgjithësi që flasin për transmetuesit që kanë ngatërruar në hadith, kështu që nuk mund ta përforcojë transmetimin e Ibn Ebu Lejlës.

Transmetojnë: Tavusi, Ebu Xhemre dhe Atai se e kanë parë Ibn Abasin duke i ngritur duart kur shkonte në ruku dhe kur e ngrinte kokën nga rukuja.

Nëse vërtetohet hadithi që e transmeton Ibn Ebu Lejla, ku thotë: **“Duart nuk ngrihen përveçse në shtatë vende”**, përsëri në hadithin që e transmeton Vekiu nuk qëndrojnë fjalët, se duart nuk ngrihen përveçse në shtatë vende.

Prandaj, duart do të ngrihen në këto vende, e do të ngrihen kur shkohet në ruku dhe kur të ngrihet koka nga rukuja, kështu që do të punojmë me të gjitha hadithet, dhe kjo nuk bie në kontradiktë.

Këta njerëz që mohojnë (ngritjen e duarve) thonë se duart ngrihen (më shumë se një herë) në tekbiret e dy Bajrameve, të Fitrit e të Kurbanit, që të gjitha këto tekbire së bashku bëjnë katërmëdhjetë sosh sipas fjalëve të tyre, dhe këto (tekbire) nuk janë përmendur në hadithin e Ibn Ebu Lejlës, gjë që tregon se ata nuk janë mbështetur në hadithin e Ibn Ebu Lejlës, ndërsa disa dijetarë nga Kufja thanë: “Duart ngrihen në tekbiret e namazit të xhenazes, që janë katër tekbire, ndërsa të gjitha këto (tekbire) konsiderohen shtesë në hadithin e Ibn Ebu Lejlës.”

Gjithashtu është transmetuar nga Pejgamberi ﷺ, në shumë zinxhirë të transmetimeve se ai i ka ngritur duart përtej këtyre shtatë vendeve të përmendura.

Hadithi 71

Na ka treguar Musa ibn Ismaili, na ka treguar Hamad ibn Seleme, e ky nga Thabiti, e ky nga Enesi (radiallahu anhu) se ke thënë: **“Pejgamberi ﷺ i ngrinte duart për namazin e kërkimit të shiut (istiska).”**¹

¹ Ky transmetim është sahih. Gjithashtu këtë e shënon edhe Muslimi në “Sahih” (896).

Hadithi 72

Na ka treguar Musededi, na ka treguar Ebu Avane, e ky nga Simak ibn Harbi, e ky nga Ikrime, e ky nga Aishja, ku Ikrime pohon se e ka dëgjuar Aishen se ajo e ka parë Pejgamberin ﷺ duke u lutur me duar të ngritura, duke thënë: **“Unë jam vetëm njeri, prandaj mos më dëno, cilindo njeri nga besimtarët e kam lënduar ose ofenduar, mos më ndëshko për këtë!”**¹

¹ Zinxhiri i transmetimit është daif. Po ashtu këtë e shënon imam Buhariu në “Edebu-l-Mufred” përmes Musededit.

Transmetimi që transmeton Simaku nga Ikrime çdoherë konsiderohet daif. Shiko: “Tehdhibu Tehdhib” dhe të tjera.

Afani përmes Musededit e transmeton të njëjtin transmetim në “Musned” tek Ahmedi (6/258).

Vërejtje: Ky transmetim është në “Sahihun e Muslimit” me këtë kuptim, pa frazën ku thotë: “Me duar të ngritura”.

Hadithi 73

Na ka treguar Aliu (ibn Medini), na ka treguar Sufjani (ibn Ujejne), e ky nga Ebu Zinadi, e ky nga el Arexhi, e ky nga Ebu Hurejra, i cili ka thënë: **“I Dërguari i Allahut ﷺ u soll nga kibla, u përgatit (për dua) dhe i ngriti duart e tij e tha: “O Allah, udhëzoje (fisni) deus dhe ktheje në (Islam)!”¹**

¹ Sahih.

Imam Buhariu gjithashtu e shënon këtë transmetim në “Edebul-Mufred” (611), nga Ali ibn Medini. Për më shumë informacione shiko te “Musnedi i Humejdit”. Këtë transmetim e ka përmendur të shkurtër Buhariu në *Sahihun* e tij.

Hadithi 74

Na ka treguar Ebu Numani, na ka treguar Hamad ibn Zejdi, na ka treguar Haxhaxh ibn Savafi, i cili ka thënë: “Nga Ebu Zubejri, e ky nga Xhabir ibn Abdullahu, se Tufejl ibn Amri i tha Pejgamberit ﷺ: “A ke nevojë për mbrojtje dhe fuqi të deusit?” Atëherë, Pejgamberi ﷺ e refuzoi këtë për atë që Allahu kishte përgatitur për ensarët. Tufejli dhe një njeri nga populli i tij bënë hixhret, ndërkohë personi në fjalë u sëmur dhe shkoi e i mori një bri dhe një shigjetë të hekurt e ia preu damarët e qafës dhe vdiq. Tufejli e pa në ëndërr dhe i tha: “Çfarë bëri Allahu me ty?” Ky iu përgjigj: “Allahu m’i fali mëkatet për hixhretin që bëra për te Pejgamberi ﷺ!” E pyeti përsëri: “Çfarë kanë duart tuaja!?” Ky u përgjigj: “M’u tha: “Nuk do ti përmirësojmë ata që vetë i ke prishur me duart e veta!” Tufejli ia tregoi këtë ëndërr Pejgamberit ﷺ, e atëherë ai i u lut duke thënë: “O Allah, duart e tij dhe atë fale!” dhe i ngriti duart e veta.”¹

¹ Sahih.

Hadithi 75

Na ka treguar Kutejbe, na ka treguar Abdulaziz ibn Muhamedi, e ky nga Alkame ibn Ebu Alkame, e ky nga nëna e tij (Merxhane), e ky nga Aishja, e cila ka thënë: **“Një natë doli i Dërguari i Allahut ﷺ, kështu që e dërgova Berirën që ta përcjellë se ku është duke shkuar. Ai shkoi te Bekije el Garkad (Varrezat e Medinës), qëndroi mes varrezave dhe i ngriti duart e tij, pastaj u largua. Berira u kthye dhe më tregoi. Të nesërmen, kur zbardhi dita, e pyeta: “O i Dërguari i Allahut, ku ishe natën mbrëmë?” Tha: “Jam dërguar për të banorët e Bekijes, që të lutem për ta!”¹**

¹ Zinxhiri është hasen.

Ibn Hibani në “El-Ihsan”, 3740, “El-Hakim”, 1/488 dhe Dhehebiu e kanë vlerësuar sahih. Gjithashtu ky hadith ka dëshmi të “Sahihu i imam Muslimit” (103,974).

Gjithashtu e ka përmendur hafidh Ibn Haxheri në “El-Feth” dhe e ka saktësuar (11/142). Sh. p.

Hadithi 76

Na ka treguar Muslimi (ibn Ibrahim), na ka treguar Shube, nga Abdurabih ibn Seidi, nga

Muhamed ibn Ibrahim et Tejmi, i cili ka thënë: **“Më ka treguar ai që e ka parë Pejgamberin ﷺ duke u lutur afër te Gurët e Vajit me duar të ngritura.”**¹

¹ Zinxhiri i transmetimit është sahih.

Gjithashtu këtë e shënon edhe Ebu Davudi (1172) në *Sunenin* e tij nga Muslim ibn Ibrahim.

Hadithi 77

Na ka treguar Jahja ibn Musai, na ka treguar Abdelhumejdi, na ka treguar Ismaili, - që është

Ibn Adbulmeliku, - e ky nga Ibn Ebu Mulejke, e ky nga Aishja, e cila ka thënë: **“E kam parë të Dërguarin e Allahut ﷺ duke u lutur me duar të ngritura lart, derisa iu panë sqetullat e tij: ai lutej për Othmanin (radiallahu anhu).”**¹

¹ Zinxhiri është daif.

Ismail ibn Adbulmeliku është i dobët sipas shumicës së dijetarëve të hadithit e, megjithatë hafidh el Hejthemi e ka konsideruar hasen këtë zinxhir të transmetimit. (“Mexhmua Zevaid”, 9/85)

Hadithi 78

Na ka treguar Ebu Nuajmi, na ka treguar el Fudajl ibn Merzuku, e ky nga Adij ibn Thabiti, e ky nga Ebu Hazimi, e ky nga Ebu Hurejra, i cili ka thënë: **“Pejgamberi ﷺ përmendi njeriun udhëtar me flokë të pakrehur e i pluhurosur, duke i ngritur duart e tij drejt Allahut të Madhëruar (duke thënë): “O Zoti im! O Zoti im!” Mirëpo, ushqimi i tij është haram, pija e tij është haram, veshja e tij është haram, është ushqyer me haram, e si t’i përgjigjet lutja atij?”**¹

¹ Sahih.

Gjithashtu gjendet te Muslimi në “Sahih” (1050), nëpërmjet Fudajl ibn Merzukut.

Hadithi 79

Na ka treguar Muslimi (ibn Ibrahim), na ka informuar Abdullah ibn Davudi nga Nuajm ibn Hakimi, e ky nga Ebu Merjemi, e ky nga Aliu (radijallahu anhu), i cili ka thënë: **“E pashë gruan e Velidit (ibn Ukbes) që erdhi te Pejgamberi ﷺ dhe iu ankua për burrin e saj, se ai e rrihte, e ai i tha: “Kthehu tek ai dhe thuaji atij kështu e kështu.” Kështu, ajo shkoi dhe përsëri u kthye duke iu ankuar përsëri se ai e rrihte, e ai përsëri i tha: “Shko tek ai dhe thuaji atij se vërtet Pejgamberi ﷺ është duke të thënë kështu (të mos më rrahësh).” Ajo përsëri shkoi e përsëri u kthye e i tha: “Ai përsëri më ka rrahur!” Pejgamberi ﷺ përsëri i tha: “Thuaja atij këto fjalë!” Ajo tha: “Ai po më rrah!” Atëherë Pejgamberi ﷺ i ngriti duart lart dhe tha: “O Allah, dënoje Velidin!”¹**

¹ Zinxhiri është hasen.

Ebu Merjem eth Thekafi është i besueshëm sipas Ibn Hibanit dhe Dhehebiut, kështu që ky hadith është në shkallën hasen (i mirë).

Hafidh el Hejthemi ka thënë: “Trasmetuesit e tij janë të besueshëm.” (“Mexhuma Zevaid”, 4/332). Për më shumë informacion për Velid ibn Ukben shiko: “Sijer el-Alam Nubela”, 3/412.

Hadithi 80

Na ka treguar Muhamed ibn Selami, na ka informuar Ismail ibn Xhareri nga Humejdi, e ky nga Enesi, i cili ka thënë: “Një vit nuk ra shi dhe u bë thatësirë e madhe, kështu që disa muslimanë shkuan te Pejgamberi ﷺ në ditën e xhuma dhe i thanë: “O i Dërguari i Allahut, shi nuk po bie e toka është tharë dhe pasuria na është shkatërrua!” Atëherë Pejgamberi ﷺ i ngriti duart lart, ndërkohë në qiell nuk kishte asnjë re. Aq lart i ngriti duart, sa që iu pa bardhësia nën sqetullat e tij, duke iu lutur Allahut të Madhëruar që të bjerë shi. Pa e mbaruar namazin e xhumasë, njerëzit u bënë merak që të kthehen te familjet në shtëpitë e tyre. Xhumanë vijuese i njëjti njeri erdhi dhe tha: “O i Dërguari i Allahut, shtëpitë tona u rrënuan dhe rrugët u mbyllën (për shkak të shiut)!”

Pejgamberi ﷺ buzëqeshi për ngutjen e shpejtë të bijve të Ademit, e atëherë i ngriti duart dhe u lut: “O Allah, përreth nesh e jo sipër nesh!” Atëherë retë u shpërndanë dhe u larguan nga Medina.”¹

¹ Sahih.

Imam Ibn Huzejme e ka konsideruar sahih (1789). Për këtë ka edhe shumë dëshmi në *Sahihun* e Buhariut (933) dhe të Muslimit (897).

Hadithi 81

Na ka treguar Musededi, na ka treguar Jahja ibn Seidi (el Katani) nga Xhaferi, më ka treguar Ebu Othmani, i cili ka thënë: **“Kemi ardhur në kohën kur Omeri u printe njerëzve në namaz, pastaj lexoi kunutin me ne dhe pas rukusë i ngriti duart derisa iu zbuluan shuplakat dhe bërrylat.”**¹

¹ Zinxhiri i transmetimit është daif.

Ibn Ebu Shejbe ka titulluar një kapitull në këtë hadith se kjo ka të bëjë me kunutin në namazin e sabahut. Transmetuesi Xhafer ibn Mejmoni është i dobët sipas shumicës së dijetarëve të hadithit.

Hadithi 82

Na ka treguar Kabisa (ibn Ukbe), na ka treguar Sufjani nga Ebu Alije, përkatësisht Xhafer ibn Mejmuni, shitësi i yrnekëve, i cili ka thënë: “E kam dëgjuar Ebu Othmanin duke thënë: **“Omeri i ngrinte duart e tij në kunut.”**”¹

¹ Zinxhirin e ka daif.

Hadithi 83

Na ka treguar Abdurrahman el Muharibi, na ka treguar Zaide nga Lejthiu, e ky nga Abdurrahman ibn Esvedi, e ky nga babai i tij, se Abdullahu (ibn Mesudi): **“Lexonte në rekatin e fundit të vitrit: “Kul huvallahu ehad”, pastaj i ngrinte duart e tij dhe kunutin e bënte para rukusë.”**¹

Imam Buhariu ka thënë: “Të gjitha këto hadithe të transmetuara nga i Dërguari i Allahut ﷺ janë të sakta. Nuk kanë mospërputhje njëra me tjetrën dhe nuk ka kontradiktë në to, sepse kjo ishte praktika në rrethana të ndryshme.

¹ Zinxhirin e ka daif.

Lejth ibn Ebu Sulejmi është i dobët sipas shumicës së dijetarëve të hadithit. Gjithashtu memoria i është dobësuar në pleqëri dhe është i akuzuar edhe për tedlis.

Hadithi 84

Thabiti, duke transmetuar nga Enesi, ka thënë: **“Nuk e kam parë Pejgamberin ﷺ duke i ngritur duart në dua, përveçse në istiska (duanë për kërkimin e shiut).”**¹

Enesi tregon atë që ka parë nga Pejgamberi ﷺ, ndërsa ky hadith nuk e kundërshton hadithin e ngritjes së duarve në tekbin fillstar të namazit.

Gjithashtu vetë Enesi ka transmetuar se Pejgamberi ﷺ i ka ngritur duart kur merrte tekbin dhe kur shkante në ruku, kështu që fjala e tij këtu “në dua” është ndryshe me atë të ngritjes së duarve në namaz dhe në dua të kunutit.

¹ Sahih.

Këtë e transmeton edhe Buhariu në *Sahihun* e tij dhe Muslimi me të njëjtin kuptim.

Hadithi 85

Na ka treguar Muhamed ibn Beshari nga Jahja ibn Seidi, e ky nga Humejdi, e ky nga Enesi se ai: **“I ngrinte duart kur shkonte në ruku.”**¹

¹ Sahih. Zinxhiri është i dobët për shkak të tecllisit të Humejd Tavilit, por ekzistojnë transmetime të tjera që e përforcojnë.

Hadithi 86

Na ka treguar Adem ibn Ebu Ijasi, na ka treguar Shube, na ka treguar Katadja nga Nasr ibn Asimi, e ky nga Malik ibn Huvejrithi, i cili ka thënë: **“Pejgamberi ﷺ i ngrinte duart kur merrte tekbir dhe kur shkonte në ruku e kur e ngrinte kokën nga rukuja, deri afër veshëve të tij.”**¹

Imam Buhariu ka thënë: “Ata që thonë se Pejgamberi ﷺ i ka ngritur duart kur shkonte në ruku dhe kur e ngrinte kokën nga rukuja dhe atë që ka shtuar Ebu Humejdi nga dhjetë shokët e Pejgamberit ﷺ, se ai ﷺ, kur ngrihej prej rekatit të dytë, i ngrinte duart, që të gjitha këto janë të sakta, për shkak se ata nuk kanë rrëfyer për një namaz që të ketë kundërthënie për këtë namaz, kështu që nuk ka kundërthënie në këtë. Disa prej sahabëve (të cilët kanë dëgjuar më shumë fjalë ose kanë parë më shumë veprime nga sahabët e tjerë) kanë shtuar (transmetime), ndërsa shtesa është e pranuar te dijetarët.

Ajo që transmeton Ebu Bekër ibn Ajashi nga Husajni, e ky nga Muxhahidi, i cili ka thënë: **“Nuk e kam parë Ibn Omerin duke i ngritur duart në namaz, përveçse në tekbirin fillestar.”** Ky transmetim është në kundërshtim me atë që transmeton

¹ Sahih.

Muxhahidi.¹ Vekiu ka thënë: Transmetohet nga Rebi ibn Subejhu se ka thënë: **“E kam parë Muxhahidin duke i ngritur duart e tij.”**

Abdurrahman ibn Mehdiu ka thënë: “Nga Rebia: **“E kam parë Muxhahidin duke i ngritur duart e tij, kur përkulej në ruku dhe kur e ngrinte kokën nga rukuja.”**”²

Xheriri ka thënë: “Nga Lejthiu, e ky nga Muxhahidi se ai: **“I ngrinte duart e tij.”** Kjo është ajo që është më e sakta te dijetarët.”³

Sadaka ka thënë: “Ai që e transmeton këtë hadith nga Muxhahidi, e ky nga Ibn Omeri se ai nuk i ka ngritur duart vetëm se në tekbirin fillestar, shoku i tij (Ebu Bekër ibn Ajashi) e ka humbur kujtesën (memorien) në vitet e fundit të jetës.

Ajo që transmeton Rebia dhe Lejthiu janë më të sakta. Përveç tyre, edhe Tavusi, Salimi, Nafiu, Ebu Zubejri, Muharib ibn Dithari dhe të tjerët kanë thënë: **“E kemi parë Ibn Omerin duke i ngritur duart kur merrte tekbirin dhe kur përkulej në ruku.”**

¹ Shiko komentin e imam Buhariut në hadithin e 13-të për këtë.

² Shiko hadithin 57.

³ Shiko hadithin 53.

Hadithi 87

Mubeshir ibn Ismaili ka thënë: “Na ka treguar Temam ibn Nexhihu, i cili ka thënë: “Omer ibn

Abdulazizi zbriti në portën e Helepit e pastaj tha: **“Hajde me ne të marrim pjesë në namazin me prijësin e besimtarëve.”** Kështu, ai na fali namazin e drekës dhe të ikindisë, e unë e pashë duke i ngritur duart kur përkulej në ruku.”¹

¹ Zinxhirin e ka daif.

Temam ibn Nexhihu është i dobët sipas shumicës së dijetarëve të hadithit.

Vërejtje: Hafidh Ebu Haxhaxh el Mizi e transmeton të njëjtin transmetim me referencë tek imam Buhariu.

(“Tehdhibu et-Tehdhib”, 3/212).

Këtë e ka përmendur imam Buhariu si dëshmi se ngritja e duarve nga Omer ibn Abdulazizi është vërtetuar, siç është përmendur më herët.

Hadithi 88

Na ka treguar Muhamed ibn Mukatili, na ka informuar Addullahu (ibn Mubareku), na ka informuar Junusi (ibn Jezid el Ejli), nga Zuhriu, e ky nga Salim, e ky nga Abdullah ibn Omeri, i cili ka thënë: **“E kam parë të Dërguarin e Allahut ﷺ, kur ngrihej për namaz duke i ngritur duart lart në mënyrë paralele me shpatullat e tij. Ashtu vepronte edhe kur merrte tekbirin për ruku, edhe kur e ngrinte kokën e tij nga rukuja, dhe thoshte: “Semiallahu limen hamideh”, ndërsa këtë nuk e vepronte në sexhde.”**¹

¹ Sahih.

Imam Buhariu gjithashtu e shënon këtë në sahih (736), nga Muhamed ibn Mukatili.

Hadithi 89

Na ka treguar Musa ibn Ismaili, na ka treguar Hamad ibn Seleme nga Jahja ibn Ebu Ishaku, i cili ka thënë: **“E kam parë Enes ibn Malikun (Allahu qoftë i kënaqur me të!) duke i ngritur duart në mes dy sexhdeve.”**¹

Imam Buhariu ka thënë: “Hadithi i Pejgamberit ﷺ është më parësor.”²

¹ Zinxhirin e ka sahih.

² Imam Buhariu me këtë ka për qëllim se nëse vepra e sahabiut e kundërshton hadithin e Pejgamberit ﷺ, ajo nuk është argument. Sh. p.

Hadithi 90

Na ka treguar Ali ibn Abdullahu, na ka treguar Sufjani, na ka treguar Amër ibn Dinari nga Salim ibn Abdullahu, i cili ka thënë:
“Suneti i Pejgamberit ﷺ është më parësor që të pasohet!”¹

¹ Zinxhirin e ka sahih.

Hadithi 91

Na ka treguar Kutejbe (ibn Seidi), na ka treguar Sufjani nga Abdulkerimi, e ky nga Muxhahidi, i cili ka thënë: **“Nuk ka njeri pas Pejgamberit ﷺ vetëm se mund t’i pranohet fjala e t’i refuzohet, përveç Pejgamberit ﷺ.”**¹

¹ Daif.

Edhe pse në zinxhir qëndron “an’an”, te Sufjan ibn Ujejne, përsëri Ibn Ebu Nexhihu e shënon të njëjtin transmetim nga Muxhahidi. Shiko: “El-Ahkam li ibn Hazm” (1/157). Në përgjithësi, Kurani, hadithet dhe etheret nga selefët pajtohen me këtë.

Hadithi 92

Na ka treguar Fudejk ibn Sulejman Ebu Isai, i cili ka thënë: “E pyeta Euzaiun: “O, Ebu Amër, çfarë thua për ngritjen duarve për çdo tekbir duke qenë njeriu në namaz?” Tha: “Kjo çështje është qysh më parë!”

Euzai është pyetur për imanin dhe unë isha duke dëgjuar kur ai tha: “Imani shtohet dhe pakësohet, ndërsa kush pretendon se imani nuk shtohet dhe nuk pakësohet, ai është bidatçi, prandaj kujdesu dhe ruaju nga ai!”¹

¹ Hasen. Vërejtje: Me fjalët e Euzait “Kjo çështje është qysh më parë” është për qëllim se kjo vepër (ngritja e duarve) është qysh nga koha e mëparshme. Nga kjo mësojmë se qysh nga koha e Pejgamberit ﷺ e deri te koha e Euzait, ka qenë praktikë e ngritjes së duarve.

Me fjalët “për ngritjen e duarve për çdo tekbir” mendohet për atë në fillim të namazit, kur shkon në ruku, si dhe për ngritjen e duarve për namazin e xhenazes.

Hadithi 93

Na ka treguar Muhamed ibn Arare, na ka treguar Xherir ibn Hazimi, i cili ka thënë: “E kam dëgjuar Nafiun duke thënë: **“Ibn Omeri i ngrinte duart e tij në namazin e xhenazes për çdo tekbir.”**”¹

¹ Sahih.

Ky transmetim gjithashtu përcillet merfu si fjalë e Pejgamberit ﷺ. (“Nasb er-Raje”, 2/285).

Hadithi 94

Na ka treguar Ali ibn Abdullahu, na ka treguar Abdullah ibn Idrisi, i cili ka thënë: “E kam dëgjuar Nafiun duke treguar se: **“Ibn Omeri i ngrinte duart e tij për çdo tekbir në namazin e xhenazes. Ashtu vepronte edhe (në namaze të tjera) kur ngrihej nga rekati i dytë.”**¹

¹ Sahih.

Gjithashtu këtë e shënon Ibn Ebu Shejbe (3/296), Bejhekiu (4/44) përmes Abdullah ibn Idrisit.

Vërejtja e parë: Transmetimet nga Abadullah ibn Amri nga Nafiu çdoherë janë sahih (ose hasen). Shiko:

“Tehdhibi et-Tehdhib”, kështu që ky transmetim është hasen.

Vërejtja e dytë: Ky transmetim ka dëshmi të shumta të sakta.

Hadithi 95

Na ka treguar Ahmed ibn Junusi, na ka treguar Zuhejri, na ka treguar Jahja ibn Seidi se Nafiu i ka treguar: **“Abdullah ibn Omeri, kur e falte namazin e xhenazes, i ngrinte duart.”**¹

¹ Zinxhirin e transmetimit e ka sahih.

Këtë transmetim e ka shënuar ibn Ebu Shejbe në “Musanef” (3/297), me zinxhir përmes Jahja ibn Seid el Katanit.

Vërejtja e parë: Në dorëshkrimi origjinal dhahirij qëndron: “Na ka treguar Ahmed ibn Junusi”, ndërsa në dorëshkrimin indian qëndron: “Ahmed ibn Junusi ka thënë...”

Vërejtja e dytë: Sa i përket dëgjimit të imam Buhariut nga Ahmed ibn Junusi është sahih dhe i argumentuar.

Hadithi 96

Na ka treguar Ebu Velidi, na ka treguar Omer ibn Ebu Zaide, i cili ka thënë: **“E kam parë Kajs ibn Ebu Hazimin duke marrë tekbir për namazin e xhenazes dhe i ngrinte duart për çdo tekbir.”**¹

¹ Zinxhiri i transmetimit është sahih.

Këtë transmetim po ashtu e shënon Ibn Ebu Shejbe në “Musanef” (3/296) me sened përmes Omer ibn Ebu Zaides.

Hadithi 97

Na ka treguar Muhamed ibn Ebu Bekër el Mukademi, na ka treguar Ebu Masher Jusuf el Berai, na ka treguar Musa ibn Dihkani, i cili ka thënë: **“E kam parë Eban ibn Othmanin duke falur namazin e xhenazes duke marrë tekbir katër herë dhe për çdo tekbir ai i ngrinte duart.”**¹

¹ Zinxhiri i transmetimit është daif.

Musa ibn Dihkani është transmetues i dobët. Shiko: “Tehdhibu et-Tehdhib” dhe librat e tjerë.

Hadithi 98

Na ka treguar Ali ibn Abdullahu dhe Ibrahim ibn Mundhiri se kanë thënë: Na ka treguar Man ibn Isai, na ka treguar Ebu Gusni, i cili ka thënë: **“E kam parë Nafi ibn Xhubejrin duke ngritur duart për çdo tekbir në namazin e xhenazes.”**¹

¹ Zinxhiri i transmetimit është hasen.

Hadithi 99

Na ka treguar Muhamed ibn Muthena, na ka treguar Velid ibn Muslimi duke thënë: “E kam dëgjuar Euzaiun nga Gajlan ibn Enesi duke thënë: **“E kam parë Omer ibn Abdulazizin duke ngritur duart për çdo tekbir në namazin e xhenazes.”**”¹

¹ Zinxhiri i transmetimit është daif.

Imam Ibn Ebu Shejbe po ashtu e shënon me sened përmes Euzait.

Gajlan ibn Enesi është transmetues mexhhul hal - i panjohur. Shumë transmetojnë nga ai dhe askush përveç Ibn Hibanit nuk e ka konsideruar të besueshëm.

Hadithi 100

Na ka treguar Ali ibn Abdullahu, na ka treguar Zejd ibn Hubabi, na ka treguar Abdullah ibn Alai duke thënë: **“E kam parë Mekhulin duke falur namazin e xhenazes: mori tekbir katër herë dhe i ngriti duart për çdo tekbir.”**¹

¹ Zinxhiri i transmetimit është hasen.

Hadithi 101

Na ka treguar Ali ibn Abdullahu, na ka treguar Ebu Musab Salih ibn Ubejdi, i cili ka thënë: **“E kam parë Vehb ibn Munebihun duke prezantuar në xhenaze: mori katër tekbire dhe për çdo tekbir i ngrinte duart.”**¹

¹ Zinxhiri i transmetimit është daif.

Salih ibn Ubejdi është trasmetues i panjohur dhe askush përveç Ibn Hibanit nuk e ka konsideruar të besueshëm. Imam Ebu Hatim er Razi dhe Dhehebiu e kanë konsideruar të panjohur.

Hadithi 102

Na ka treguar Ali ibn Abdullahu, na ka informuar Abdurrezaku, na ka informuar Mameri: **“Zuhriu i ngrinte duart e tij në namazin e xhenazes në çdo tekbir.”**¹

Vekiu ka thënë: “Nga Sufjani, nga Hamadi: E ka pyetur Ibrahimin (en Nehaiun) e ai tha: **“Duart ngrihen në tekbirin fillestar.”**”²

Muhamed ibn Xheriri e ka kundërshtuar (Sufjanin), nga Hamadi, e ky nga Ibrahim, e ky nga Alkame, e ky nga Abdullahu se: **“Ebu Bekri dhe Omeri (nuk i kanë ngritur duart).”**³

¹ Zinxhiri i transmetimit është sahih.

Ky transmetim është në *Musanefin* e Ibn Ebu Shejbes më fjalë të tjera (2/496). Imam Abdurrezaku ka thënë: “Ne (muhadithinët) kështu veprojmë.

Fjalët në këtë libër dhe te *Musanefi* i Abdurrezakut janë sahih, Falënderimi i takon Allahut.

² Zinxhiri i transmetimit është daif.

Transmetuesi i tij është Sufjan eth Theuriu, edhe pse ai është shumë i besueshëm dhe imam, ai është edhe mudelis, rrjedhimisht pretendimit i tij për dëgjimin e këtij hadithi nuk është i vëretuar.

³ Ky transmetim është shumë i dobët.

Trasmetuesi Muhamed ibn Xheriri është i dobët sipas shumicës së dijetarëve. Atij i është dobësuar memoria në vitet e fundit të jetës. Ky transmetim i Muhamed ibn Xheririt vlerësohet si munker – shumë i dobët, nga imami i sunetit Ahmed ibn Hanbel, i cili e ka refuzuar kategorikisht. (“Kitabu ilel”, 1/144).

Buhariu ka thënë: “Hadithi i Theuriut është më i saktë te dijetarët (se hadithi Muhamed ibn Xheririt, i cili konsiderohet i dobët), edhe pse është transmetuar nga Omeri më zinxhirë të ndryshëm të transmetimeve, se Pejgamberi ﷺ i ka ngritur duart.

Na ka treguar Muhamed ibn Jahjai se Aliu (ibn Medini) ka thënë: **“Të gjithë dijetarët që i kam parë i kanë ngritur duart në namaz.”** E pyeta (Buhariu): **“Sufjan (ibn Ujejne) a i ka ngritur duart e tij?”** Tha: **“Po.”**

Imam Buhariu ka thënë: “Ahmed ibn Hanbeli ka thënë: **“E kam parë Mutemirin (ibn Sulejmanin), Jahja ibn Seidin, Abdurrahmanin (ibn Mehdiun), Ismailin (ibn Ulejen) duke i ngritur duart kur përkuleshin në ruku dhe kur i ngrinin kokat nga rukuja.”**¹

Na ka treguar Ali ibn Abdullahu, na ka treguar Ibn Ebu Adiu nga Eshathi duke thënë: **“Haseni (el Basriu) i ngrinte duart për çdo tekbir në namazin e xhenazes.”**²

* * * * *

Këtu përfundon libri i imam Buhariut (Allahu e mëshiroftë!). Falënderimi i takon vetëm Allahut, bekimet dhe paqja qoftë për pejgamberin tonë Muhamed ﷺ, familjen e tij, shokët e tij dha ata të cilët e pasojnë me mirësi deri në Ditën Gjykimit! Libri është

¹ Sahih. Zinxhirët e ethereve të përmendura janë sahih.

² Zinxhiri i transmetimit është sahih.

NGRITJA E DUARVE (PARA DHE PAS RUKUSË) NË NAMAZ

marrë nga kopja dhe dorëshkrimi i hafidh Ibn Haxher el Askalanit (Allahu e mëshiroftë!).

(Dorëshkruesi) thotë: “I kam parë këto fjalë të shkruara në fund: Ebu Fadl Ahmed ibn Ali ibn

Muhamed esh Shafi el Askalni, i njohur si Ibn Haxheri, e ka shkruar (këtë version) për veten e tij.”

Falënderimi i takon vetëm Allahut, fund e krye!

Përmbajtja

Parathënie	9
Hadithi 1	24
Hadithi 2	28
Hadithi 3	29
Hadithi 4	31
Hadithi 5	32
Hadithi 6	33
Hadithi 7	34
Hadithi 8	35
Hadithi 9	36
Hadithi 10	39
Hadithi 11	40

Hadithi 12	41
Hadithi 13	42
Hadithi 14	46
Hadithi 15	47
Hadithi 16	48
Hadithi 17	49
Hadithi 18	50
Hadithi 19	51
Hadithi 20	52
Hadithi 21	53
Hadithi 22	54
Hadithi 23	55
Hadithi 24	56
Hadithi 25	58

Hadithi 26	59
Hadithi 27	60
Hadithi 28	62
Hadithi 29	64
Hadithi 30	66
Hadithi 31	69
Hadithi 32	70
Hadithi 33	71
Hadithi 34	73
Hadithi 35	74
Hadithi 36	76
Hadithi 37	77
Hadithi 38	79
Hadithi 39	82
Hadithi 40	83

Hadithi 41	84
Hadithi 42	85
Hadithi 43	86
Hadithi 44	87
Hadithi 45	88
Hadithi 46	89
Hadithi 47	90
Hadithi 48	91
Hadithi 49	92
Hadithi 50	93
Hadithi 51	94
Hadithi 52	95
Hadithi 53	96
Hadithi 54	97
Hadithi 55	98

Hadithi 56	99
Hadithi 57	100
Hadithi 58	101
Hadithi 59	102
Hadithi 60	103
Hadithi 61	104
Hadithi 62	106
Hadithi 63	107
Hadithi 64	108
Hadithi 65	109
Hadithi 66	111
Hadithi 67	112
Hadithi 68	113
Hadithi 69	114
Hadithi 70	115

Hadithi 71	118
Hadithi 72	119
Hadithi 73	120
Hadithi 74	121
Hadithi 75	122
Hadithi 76	123
Hadithi 77	124
Hadithi 78	125
Hadithi 79	126
Hadithi 80	127
Hadithi 81	128
Hadithi 82	129
Hadithi 83	130
Hadithi 84	131
Hadithi 85	132

Hadithi 86	133
Hadithi 87	135
Hadithi 88	136
Hadithi 89	137
Hadithi 90	138
Hadithi 91	139
Hadithi 92	140
Hadithi 93	141
Hadithi 94	142
Hadithi 95	143
Hadithi 96	144
Hadithi 97	145
Hadithi 98	146
Hadithi 99	147
Hadithi 100	148

NGRITJA E DUARVE (PARA DHE PAS RUKUSË) NË NAMAZ

Hadithi 101	149
Hadithi 102	150
Përmbajtja.....	153